



Kolegji Universitar “Logos”
Fakulteti i Shkencave Humane
Master i Shkencave në Turizëm Religjöz

Punim Diplome

Artjola Prifti

LO221B10003

Toleranca fetare midis komuniteteve kryesore në Shqipëri

Profesori mbikëqyrës: PhD. Atë Stephanos Ritsi

Tiranë, 2023

Abstrakt

Ky punim ka si synim kryesor tolerancën fetare midis komuniteteve fetare të vendin tonë, si edhe njohjen dhe mendimet që kanë të rinjtë në lidhje me të. Kërkojmë të mësojmë më tepër mbi këtë çështje dhe, si ndihmë për këtë, do të përdorim intervistat zanore anonime. Në këtë mënyrë do të kuptojmë më qartësisht se nëse toleranca fetare, pra ky fenomen, ekziston vërtet apo ka mbetur thjesht një mit nga e shkuara. Duke qenë se Shqipëria mban kurorë si një vend me tolerancë të lartë fetare, do të kuptojmë mendimet që kanë të rinjtë mbi këtë faktor, meqenëse ata janë edhe e ardhmja e këtij vendi. Kështu do të arrijmë të kuptojmë më tepër mbi tolerancën.

Fjalët kyç: tolerancë fetare, fe, komunitete fetare, mit, konferencë, intolerancë.

Abstract

The primary goal of this work is to discuss religious tolerance between the religious communities in our country and also the knowledge and thoughts that the young generation has about it. We try to learn more about this topic and as tool to help us in this process we'll use anonymous vocal interviews. In this way we'll clearly understand if the phenomenon of religious tolerance really exists, or it's just a myth of the past. Given that Albania is renowned as a country with a high religious tolerance we'll understand the young peoples' thoughts on this factor because they are the future of this country. By doing so we'll understand more about tolerance.

Key words: religious tolerance, religion, religious communities, myth, conference, intolerance.

Mirënjohje dhe falënderime

Punimi i temës së diplomës kërkon përkushtim dhe mund të madh për t'u realizuar. Ky realizim nuk mund të bëhej pa përkrahje, ndaj i jam mirënjohëse dhe i falënderoj pafundësisht ata që më kanë mbështetur përgjatë gjithë rrugëtimit tim shkencor.

Është e vështirë të gesh fjalët e duhura për të shprehur mirënjohje dhe falënderime të pafundme ndaj Kryepiskopit të Tiranës, Durrësit dhe gjithë Shqipërisë, imzot Anastasit, për mundësinë që më ka dhënë për të ndjekur studimet në këtë universitet.

Një falënderim i veçantë i shkon Phd. Atë Stefan Ritsi, mentorit tim të nderuar, i cili më ndihmoi shumë me udhëzimet e vazhdueshme që më jepte në lidhje me punimin tim. Një falënderim i shkon edhe stafit pedagogjik që ka kontribuar në studimet e mia, falë njohurive që zotëron.

Gjithashtu, do të doja të përmendja dhe atin tim shpirtëror, Hirësi Nikollën, për gjithë mbështetjen, këshillat, dashurinë që më ka dhuruar gjatë viteve të mia të studimit.

Dhe, në fund, një falënderim i sinqertë i dedikohet familjes sime, e cila, me dashurinë dhe përkujdesjen e saj, më ka mbështetur gjatë kohës së studimeve të mia duke më dhënë forcë dhe kurajë për të ecur përpara.

Tabela e përmbajtjes

Abstrakt.....	2
Abstract.....	3
Mirënjohje dhe falënderime.....	4
Hyrje	7
Kapitulli i parë	9
Fillimi i veprimtarisë së komuniteteve fetare kryesore në Shqipëri	9
Kapitulli i dytë	19
Takimet midis komuniteteve fetare ndër vite	19
Konferenca	20
Deklarata	25
Kapitulli i tretë.....	31
Toleranca fetare - mit apo e vërtetë?.....	31
Kapitulli i katërt	41
Diskutim mbi intervistat	41
Përfundim	49
Bibliografia	51

Vërtetë ne kemi Bajram e Pashkë, por Shqiptarinë e kemi bashkë.
Gjergj Fishta

Hyrje

Shqiptarët gjithmonë janë shquar si popull me kulturë, tradita, zakone të trashëguara brez pas brezi dhe me respekt dhe dashuri gjithmonë në zemrat e tyre për njëri-tjetrin. Ky popull është dalluar gjithashtu për trimëri të lartë dhe besnikëri dhe si një nga kombet më të vjetra në Ballkan. Shqiptarët, një popull i vuajtur, që ka e përqaftuar që herët besimin, duke qenë se gjithmonë kanë qenë përballë sfidave, vështirësive dhe, si çdo popull, gjithmonë kanë pasur nevojë për Zotin. Ky vend laik, me shumë besime fetare në përbërje të tij, gjithmonë është parë në përputhje me tolerancën. Toleranca fetare është parë dhe trajtuar gjithmonë si një vlerë e jashtëzakonshme e këtij populli, një vlerë krenarie. Pra, shqiptarët e konsiderojnë tolerancën fetare, si një vlerë të tyre themelore, një vlerë që i dallon nga popujt e tjerë, një vlerë morale, shoqërore ku përfshihet bashkëjetesa me të gjitha besimet.

Çdo studim, domosdoshmërisht, duhet të ketë një qëllim, që të përcaktohet metoda e realizmit të punimit. Prandaj, edhe në kuadër të këtij punimi, nuk mund të realizohet pa pasur një qëllim. Në këtë rast punimi i diplomës është që, përmes hulumtimit dhe analizës, t'u ofrojë mundësi lexuesve që ta kuptojnë qartë dhe drejt tolerancën fetare në vendin tonë.

Në kapitullin e parë, studimi nis me historikun e ardhjes së komuniteteve fetare në Shqipëri, gjë që mund të përshkruhet me një fjali: “Evolucioni i fenomenit fetar në Shqipëri përmbledhet në një frazë të vetme: feja ka kaluar nga qenia në mosqenie dhe përsëri në qenie”¹. Fillimisht, në hyrje të këtij kapitulli do të japim një përshkrim të shkurtër mbi historinë e këtij vendi, pozitën gjeografike dhe përbërjen statistikore sipas religjionit të popullsisë së tij. Më pas, do të njihemi me ardhjen e religjionit të parë në këtë vend dhe do të vazhdojmë me religjionet e tjera dhe njohjen e historisë së ardhjes së tyre. Vëmendje e veçantë do t'i jepet edhe shtypjes brutale që i ndodhi religjioneve të Shqipërisë në vitin 1967, ku u ndalua me ligj religjioni dhe Shqipëria u shpall vendi i parë ateist në botë. Kjo bëri që brezi nga 1967 deri 1990 të mos kishte fare njohuri në lidhje me religjionin dhe ritet e tij. Pas kësaj, një përqendrim i madh do t'i jepet edhe hapjes, lulëzimit të

¹ Gj. Sinani, *Feja dhe edukimi*, Friedrich Ebert Stiftung, Tiranë 2017, fq. 6.

komuniteteve religjioze në vitin 1990, ringritja e tyre, zhvillimi, sektet e tjera që erdhën etj. Pra, duke i parë religjionet nga ky prizëm që nga ardhja fillestare në këtë vend, do të kemi mundësi të krijojmë një ide të qartë në lidhje me secilin prej tyre.

Në kapitullin e dytë do të njihemi me krijimin e KNFSH-së (Këshilli Ndërfetar Shqiptar), duke përfshirë këtu edhe pjesët përbërëse të këtij këshilli. Do të analizojmë dhe do të shikojmë me kujdes dhe vëmendje të veçantë të gjitha konferencat në të cilat ka marrë pjesë KNFSH-ja si brenda dhe jashtë vendit, që nga krijimi i saj dhe deri më sot. Më pas, një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet deklaratave të KNFSH-së. Këshilli Ndërfetar Shqiptar ka dalë në disa deklarata në situata të ndryshme që kanë ndodhur në vendin tonë, si ato në që i përkasin religjionit dhe që përfshihen komunitetet, por edhe në ato që kanë të bëjë me situata ekonomike, politike, sociale, etj. Duke njohur më mirë krijimin e këtij komuniteti, me marrjen pjesë të pesë komuniteteve kryesore të vendit tonë, si Komuniteti i Krishterë Orthodhoks, Komuniteti Mysliman, Komuniteti Bektashi, Komuniteti Romano-Katolik dhe Vëllazëria Ungjillore, do të krijojmë një imazh më të qartë në lidhje me prioritetin tonë themelor, tolerancën fetare.

Në kapitullin e tretë, për të cilin mund të themi që është edhe kapitulli më i rëndësishëm, do të shqyrtojmë dhe do të analizojmë tolerancën fetare, duke marrë dhe dëgjuar mendimet e të rinjve shqiptarë nga qytete të ndryshme të këtij vendi. Do të zhvillojmë intervista të shkurtra, anonime dhe, në këtë mënyrë, do të mësojmë sesa të lidhur janë të rinjtë e vendit tonë me religjionin dhe sa prej tyre mendojnë në ekzistencën e vërtetë të tolerancës, bashkëjetesës dhe harmonisë fetare. Është interesant mendimi dhe i veçantë i të rinjve, sepse ata personifikojnë dhe të ardhmen e këtij vendi.

Në kapitullin e katërt (i fundit), do të paraqesim rezultatet e intervistave me të rinjtë dhe për këtë qëllim do të përdorim metodën sasiore. Si fund, do të nxjerrim konkluzionet që kemi marrë nga të rinjtë për të parë se, sipas tyre, mos ndoshta toleranca shihet si mit apo e vërtetë krenarie e këtij populli.

Kapitulli i parë

Fillimi i veprimtarisë së komuniteteve fetare kryesore në Shqipëri

Ky kapitull përshkruan, në pikëpamje të përgjithshme, ardhjen e komuniteteve fetare në Shqipëri. Vëmendje e veçantë do t'i jepet edhe periudhës komuniste dhe rihapjes përsëri të komuniteteve. Gjithashtu, një përqendrim i shkurtër do t'i jepet edhe historisë së shkurtër të këtij kombi. Në këtë mënyrë do ta kemi më të qartë historinë e ardhjes së komuniteteve fetare në këtë vend.

Shqipëria ndodhet në juglindje të Evropës, pra në pjesën perëndimore të Gadishullit Ballkanik. Ky popull, së bashku me atë grek, është më i vjetri në Gadishull. Paraardhësit e këtyre dy popujve, ilirët dhe pellazgët, zotëronin një qytetërim të lartë duke pasur kështu Adriatikun, Ballkanin Perëndimor dhe duke u shtrirë më gjerë. Në shekullin II para Krishtit, ndodhën luftërat iliro-romake që përfunduan me nënshtrimin e ilirëve ndaj Perandorisë Romake².

Më vonë, Iliria vazhdoi me sulmet e fiseve barbare sllave, të cilat më pas vazhduan me sulmet dhe pushtimet e osmanëve. Për rreth 2000 vjet, shqiptarët vuajtën deri në vitin 1912 ku morën Pavarësinë. Më 1928 u themelua Mbretëria Shqiptare dhe më 1946 Republika Popullore. Një nga regjimet më të egra që kaloi ky popull, ishte ai komunist që u shemb më 1990. Shqipëria sot është Republikë Parlamentare³.

Shqipëria është një vend i rrallë, me një histori fetare të ndryshme nga shumë vende të tjera. Është një nga dy vendet e Evropës që përfshin shumicë myslimane në përbërje të popullsisë së saj. Në ndryshim nga shteti i saj fqinj, Kosova, e cila në përbërje të saj ka (93,5% myslimanë), Shqipëria ka pakicë të konsiderueshme të krishterë⁴.

Në këndvështrimin historik dhe gjurmimin e origjinës së këtij vendi, gjatë shekujve të parë, feja e parë e këtij populli ka qenë Krishterimi që u predikua prej apostujve të Krishtit, pra misionarëve të parë, i cili filloi të përhapej dhe në vitin 380 nga dekreti i perandorit Theodhos, Krishterimi u

² E. Topulli, *Besimet fetare në Shqipëri*, (Punim diplome) <http://flurudha.blogspot.com/2014/06/besimet-fetare-ne-shqiperi-punim-diplome.html?m=1>. (marrë më 01.05.2023).

³ Ibid.

⁴ S. Ritsi, *The Transmission of the Gospel in the Multireligious Society of Albania and the Rediffusion to the Oikoumene*, (Doctoral Thesis), pg.39.

shpall besimi zyrtar i Perandorisë Romake. Ky dekret, duke qenë i vlefshëm, përfshinte edhe territorin e Shqipërisë dhe popullin e saj⁵.

Apostull Pavli, në letrën drejtuar Romakëve, thotë qartë: “Kështu prej Jerusalemit dhe përqark dhe gjer në Iliri, kam kryer shërbimin e ungjillit të Krishtit (Rom. 15:19). Dëshmi të shumta historike dhe arkeologjike na flasin në lidhje me kishën pasapostolike, pra: në vitin 58 na jepet emri i peshkopit të parë të Durrësit, Shën Cezari, dhe, në vitin 100, emri i peshkopit të dytë, përsëri të Durrësit, martir Shën Asti⁶.

Tradita tregon se, në Iliri, ka ardhur dhe ka predikuar besimin edhe Ungjillor Llukai. Në ungjillin sipas Llukait (10:1) tregohet që Zoti fillimisht caktoi 70 apostuj dhe, më pas, caktoi 70 të tjerë duke i ndarë dy e nga dy dhe i nisi në çdo qytet dhe vend ku shkonte Ai. Një prej apostujve të parë ishte dhe Shën Qesari, të cilin Shën Pavli e caktoi episkop të parë të Durrësit. Ferlati, në veprën e tij, na jep informacion që në vitet 58 pas Krishtit, qyteti i Durrësit kishte 70 familje⁷.

Ilirët, duke e pranuar besimin e krishterë, që në fillim u shquan si popull i krishterë. Lajmi i gëzueshëm që u transmetua në Iliri nga vetë goja e Apostujve, u trajtua si një dëshmi, nisje e re e këtij populli drejt Krishterimit⁸.

Hershmërinë e Krishterimit në vendin tonë e faktojnë pagëzimoret, bazilikat e shumta që ndodhen në qytete, si: Durrës, Shkodër, Lezhë, Elbasan, Dibër, Ohër, Tiranë, Butrint etj., gjithashtu edhe emrat e vendeve që u referohen martirëve⁹.

Në shekullin XI, luftërat e vazhdueshme që ndodhën midis Romës dhe Bizantit, sollën ndarjen e kishës, në: romano-katolike me seli në Vatikan, duke përfshirë pjesën veriore të Shqipërisë, dhe në orthodhokse me seli në Konstandinopojë, Stamboll, që përfshinte pjesën perëndimore të Shqipërisë¹⁰.

⁵ Th. Hopko, *Besimi Orthodhoks*, Tiranë: Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë, Vol. 3, 2000, fq. 190.

⁶ *Shqipëria si hapësirë e Krishterimit*, “Arbëria” 14 shtator 2014.

⁷ A. Llukani, *Historia e Krishterimit në Shqipëri*, <http://allukani.narod.ru/indeks6.htm> (marrë më 30/05/2023).

⁸ *Shqipëria si hapësirë e Krishterimit*, “Arbëria” 14 shtator 2014.

⁹ A. Janullatos, *Kisha Orthodhokse në hapësirën e Shqipërisë së Sotme*, Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë, Tiranë:2009, fq.14.

¹⁰ E.Topulli, *Besimet fetare në Shqipëri*, (Punim diplome) <http://flurudha.blogspot.com/2014/06/besimet-fetare-ne-shqiperi-punim-diplome.html?m=1> (marrë më 01/05/2023).

Në këtë gjendje e gjen kishën shqiptare sundimi turk dhe, për shkak të këtij pushtimi, një pjesë e shqiptarëve largohen duke emigruar drejt Greqisë dhe Italisë dhe pjesa tjetër qëndron duke përfituar nga të mirat që u sillte kthimi në fenë islame¹¹. Përhapja e shpejtë e fesë islame filloi me pushtimet osmane. Në fund të shekullit XVI, ritmet e përhapjes së islamit nuk ishin të njëjta si në qytet ashtu dhe në zonat rurale. Në fund të shekullit XVI, popullsia e qyteteve ishte 62% e krishterë dhe 38% ishte kthyer në fenë islame. Ndërsa në zonat rurale ritmet e përhapjes së islamit ishin më të ngadalta. Në zonat rurale të krishterët ishin 90.5% e popullsisë, ndërsa myslimanët 9.5%¹². Nga gjysma e dytë e shekullit XVI, filloi të rritej gjithnjë e më shumë ndikimi dhe roli i islamit ku filloi të dallohej kufiri midis të krishterëve dhe myslimanëve. I gjithë sistemi politik, ekonomik, shoqëror e vuri ekzistencën e të krishterëve në varësi të myslimanëve, në një joshje të vazhdueshme¹³. Përhapja e shpejtë e myslimanizmit në Shqipëri faktori me disa shkaqe, si: myslimanizmi është përhapur për shkak të dhunës që ushtruan turqit, një tjetër tezë është që myslimanizmi është përhapur në mënyrë paqësore dhe është adoptuar nga popullsia për faktin se sillte dobi tek ata si shmangia e taksave¹⁴, një tjetër arsye është se shqiptarët, me përqaftimin e myslimanizmit, mbronin identitetin e tyre etnik¹⁵.

Arsyeja e kthimit të të krishterëve në myslimanë shihet më tepër e dyta dhe kjo për faktin se të krishterët u ngarkuan me taksa të larta në lidhje me detyrimet shtetërore, me taksën e bagëtive, të gjithë administratorët e çifligjeve i përkisnin besimit mysliman¹⁶. Nga shembuj të ndryshëm dalim në konstatimin se popullsia myslimane ngarkoi me detyra ushtarake, si: vjeljen e detyrimeve shtetërore (taksat), mbrojtje të kështjellave, shtypje të kryengritjeve. Ndërsa popullsia e krishterë ngarkohej në përgjithësi me detyrime të ulëta, që përfshin: mirëmbajtjen e kështjellave, të urave, të rrugëve që, në përgjithësi, ishin punë hangari. E gjithë kjo kishte si qëllim nxitjen e popullsisë së krishterë që të përqafonte besimin mysliman, pasi puna që bënin myslimanët sillte përfitime të

¹¹ Gj. Sinani, *Feja dhe edukimi*, Friedrich Ebert Stiftung, Tiranë 2017, fq. 6.

¹² P. Thëngjilli, *Shqiptarët midis Lindjes dhe Perëndimit*, 1505-1839, fusha fetare, 1, Tiranë, 2002, fq. 38.

¹³ Ibid, pg.33.

¹⁴ Gj. Sinani, *Feja dhe edukimi*, Friedrich Ebert Stiftung, Tiranë 2017, fq. 6.

¹⁵ R. Moroco, *Kombi dhe feja në Shqipëri 1920-1944*, Shtëpia botuese Elena Lika, Tiranë, fq.21.

¹⁶ P. Thëngjilli, "Perla", *Faktorët për përhapjen e fesë islame në Shqipëri shek. XIV-XVII*, Revistë Shkencore, 2005 Nr. 2 (37) Botuesi: Fondacioni Kulturor Saadi Shirazi, Tiranë, fq. 5-6.

larta ekonomike, ndërsa ajo e popullsisë së krishterë, jo. Kjo politikë, pa diskutim, dha frytet e veta ku popullsia e krishterë u detyra të konvertohej në atë islame¹⁷.

Pra, fillimet e islamizmit në popullsinë shqiptare janë të lidhura me fillimet e vendosjes së sundimit osman. Shqipëria ishte një nga vendet e pushtuara ku u vu në funksion çdo lloj detyrimi me rreptësinë më të madhe. Detyra e mbledhjes së djemve të krishterë dhe dërgimi i tyre në Stamboll, në mënyrë që të rriteshin për t'i shërbyer Perandorisë, i ngarkohej njërit prej jeniçerëve, i cili ishte i pajisur me ferman të sulltanit¹⁸.

Ardhja e islamit në Shqipëri solli pasoja në jetën ekonomike, shoqërore dhe kulturore të shqiptarëve. U ndryshua urbanistika dhe arkitektura. Shumë kisha u kthyen në xhami, u ndërtuan shumë objekte të reja, si xhami, qendra bamirësie etj. Tradita islame u shtri në të gjitha fushat ku martesat filluan të kryheshin sipas traditës turke, disa nga gratë myslimane ndryshuan stilin e veshjes dhe një numër fjalësh turko-arabe depërtuan në shoqërinë shqiptare¹⁹.

Islami u përhap në Shqipëri jo vetëm në variantin e tij kryesor, por edhe në formën e sekteve të ndryshme si bektashizmi etj. Këtë gjë e vërtetojnë më së miri teqetë e shumta që janë ndërtuar në një numër vendbanimesh²⁰. Bektashinjtë përbëjnë urdhrin heterodoks që u përhap në shumë vende ballkanike që ishin nën pushtetin e Perandorisë Osmane. Fillimisht, bektashinjtë u shfaqën në formën e një urdhri dervishësh ku themeluesi i tyre ishte Haxhi Bektashi. Që në fillimet e tyre, ata u shpallën kundër rreptësisë doktrimore dhe shpallën dashurinë dhe vëllazërinë për të gjithë njerëzit. Shqipëria shihej si atdheu i tyre i dytë, ku, në vitin 1925, selia qendrore e bektashizmit u vendos në Tiranë. Sari Sallëtëku përmendet si një nga personat misionar në Shqipëri që mbolli farën e besimit bektashi ku qyteti i Krujës u bë qendër e rëndësishme e besimit bektashi, ku dhe Ali Pashë Tepelena shihet si një mbështetës i këtij besimi²¹.

Në shekullin XIX, shihet si fillimi i zgjimit të popujve të Ballkanit ku filloi lëvizja për fitimin e lirisë së tyre. Krahas kësaj lëvizjeje kombëtare, lindi dhe dëshira për krijimin e kishave

¹⁷ P. Thëngjilli, "Perla", *Faktorët për përhapjen e fesë islame në Shqipëri, shek. XIV-XVII*, Revistë Shkencore, 2005 Nr.2 (37) Botuesi: Fondacioni Kulturor Saadi Shirazi, Tiranë, fq. 8.

¹⁸ *Islamizmi tek shqiptarët*, "Kultura popullore", 1995 nr. 1-2, 165.

¹⁹ Ibid.

²⁰ E. Topulli, *Besimet fetare në Shqipëri*, (Punim diplome) <http://flurudha.blogspot.com/2014/06/besimet-fetare-ne-shqiperi-punim-diplome.html?m=1>. (marrë më 09/05/2023).

²¹ R. Moroco, *Kombi dhe feja në Shqipëri 1920-1944*, Shtëpia botuese Elena Lika, Tiranë, fq. 34-38.

kombëtare²². Në shtator të vitit 1922, u mbajt në qytetin e Beratit Kongresi Kishtar Orthodhoks, i cili u mbështet nga qeveria e atëhershme shqiptare dhe e shpalli Autoqefale Kishën e Shqipërisë. Por, Patriarkana Ekumenike nuk i pranoi këto vendime duke i quajtur antikanonike duke vetëshpallur gatishmërinë e saj për t'i dhënë kishës vetadministrimin²³. Si përfundim, gjatë periudhës së Patriarkut Veniamini I, në prill të vitit 1937, Patriarkana dha “Tomosin Patriarkal dhe Sinodik, Mbi Bekimin e Autoqefalisë së Kishës Orthodhokse të Shqipërisë”²⁴.

Pas kësaj, në vitin 1939, Shqipëria u pushtua nga Italia dhe më pas nga Gjermania. Vendi u kthye në provincë të Italisë, ku erdhëm misionarë katolikë, të cilët u vendosën në zona të ndryshme të Jugut²⁵. Statistikat e fundit, që datojnë në vitin 1945 tregojnë se 70% e popullsisë shqiptare ishte myslimanë, 20% të krishterë orthodhoksë dhe 10% katolikë²⁶.

Pas largimit të gjermanëve në vitin 1944, në Shqipëri u imponua regjimi komunist dhe filloi persekutimi i fesë²⁷. Më 4 prill të vitit 1967, Shqipëria u shpall vendi i parë ateist në botë dhe në histori, në të cilën çdo shprehje fetare u ndalua me kushtetutë²⁸. U zhvillua një fushatë e gjerë shtypjeje kundër besimtarëve të krishterë dhe myslimanë duke i burgosur klerikët dhe duke i përndjekur familjet e tyre. Propaganda e fortë mediatike i nxiti të rinjtë të shkatërronin vendet fetare. Sipas Muzeut të Kujtesës, në një projekt të zhvilluar nga Instituti Shqiptar i Studimeve Politike, u mbyllën 2169 institucione fetare ku përfshihen: 740 xhami, 608 kisha orthodhokse, 157 kisha katolike dhe 530 turbe (që përfshin teqe dhe mauzole osmane)²⁹.

Këto objekte u përdhosën duke u kthyer në kinema, vatra kulturore, depo, hotele, reparte ushtarake, klube, si edhe salla bagëtish. Pavarësisht nga dëmet fizike dhe materiale që shkaktoi regjimi komunist, ai nuk mund ta zhdukte dot përfundimisht besimin nga zemrat e njerëzve. Besimi arriti të mbijetonte përmes traditës popullore, ceremonive mortore, lindjeve, martesave etj. Edhe pse partia përpiqej duke qenë vigjilente për ta zhdukur totalisht dhe luftonte që mos të mbetej asgjë, disa prej njerëzve gjetën mënyrat për t'i bërë në fshehtësi festat fetare dhe simbolikat që i

²² Gj. Sinani, *Feja dhe edukimi*, Friedrich Ebert Stiftung, Tiranë 2017, fq. 6-7.

²³ A. Janullatos, *Ringritja e Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë*, Tiranë:2015, fq.11.

²⁴ Ibid.

²⁵ Ibid, fq.12.

²⁶ A. Elbasani, *Religion and Democratization in Past-Communist Albania: Is it Possible to be Islamic, Democratic and European at the Same Time*, 2010, fq.3.

²⁷ A. Janullatos, *Ringritja e Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë*, Tiranë: 2015, fq.34.

²⁸ Ibid, fq. 35.

²⁹ “Reporter. Al”, *Si u bë Shqipëria vendi i parë ateist në botë*, 28/08/2019.

shoqëronin ato. Kripto të krishterët dhe kripto myslimanët ruajtën traditat dhe nuk e harruan asnjëherë besimin e tyre, sepse ndalimi i diçkaje që ka qenë pjesë e pandashme e jetës së njeriut nuk mund të harrohet lehtë, por kthehet në “mollën e ndaluar”, e cila është më e ëmbël³⁰.

Pas përmbyesjes së regjimit komunist në vitin 1990, populli i vuajtur shqiptar ishte i etur tashmë për liri besimi. Shumë besimtarë të krishterë dhe myslimanë, të tërhequr nga dashuria e madhe dhe malli për Zotin, për t’u lutur dhe falur në ato objekte të pakta të kultit që kishin mbetur ende duke kryer kështu meshën e parë dhe falur xhumanë e parë. Ky ishte triumfi i lirisë së fesë ndaj zinxhirëve të komunizmit³¹. Pas ndryshimeve politike në Shqipëri, vendi kërkonte një kuadër ligjor për liritë fetare. Kështu, në prill të vitit 1991, nga Kuvendi i Shqipërisë në nenin 7, thuhet: “Shteti respekton lirinë e besimit fetar dhe krijon kushtet për krijimin e tij”. Gjithashtu, në vitin 1998, miratohet kushtetuta e re e vendit, e cila në nenin e saj 10 dhe 24, garanton lirinë e besimit dhe të ushtrimit të shprehjes së tij të lirë, ndryshimin e besimit dhe shfaqjen e tij hapur si në publik ashtu edhe në privat³².

Në ndryshim nga të gjitha kushtetutat e mëparshme, kjo kushtetutë, që në deklaratën e saj hyrëse të besimit të Zoti, si një vlerat themelore të këtij vendi. Edhe pse Shqipëria nuk ka një fe zyrtare dhe është asnjëherë në çështjet e besimit, përfshirja e besimit, që në hyrje të kushtetutës, jep një vlerë të rëndësishme, sepse u garanton besimtarëve dhe jobesimtarëve lirinë e besimit dhe të ndërgjegjes. Shteti shqiptar ka shkruar marrëveshje me pesë bashkësitë fetare kryesore në vend: Kisha Orthodhokse, Komuniteti Mysliman, Kryegjyshata Bektashiane, Kisha Katolike dhe Vëllazëria Ungjillore. Në këtë marrëveshje synohet rregullimi i marrëdhënieve midis shtetit dhe bashkësive fetare me dobi reciproke³³.

Pas vitit 1990, u kthyen misionarë në Shqipëri, ku përmendim: misionarët e kishës katolike të Shqipërisë, misionarët dhe të dërguarit e selisë së shenjtë ku midis tyre dhe klerikë të dalë nga burgjet, të cilët kishin mbijetuar. Klerikët orthodhoksë që kishin mbetur gjallë, filluan menjëherë të shkonin pranë kishave që i kishin mbetur nga regjimi komunist për t’i ripërtërirë ato³⁴.

³⁰ J. Topulli, *Rigjallërimi i besimeve fetare në Shqipëri pas rënies së komunizmit*, (Punim Doktorature), fq. 75-76.

³¹ <https://knfsh.al/en/>. (marrë më 09/05/2023).

³² J. Topulli, *Rigjallërimi i besimeve fetare në Shqipëri pas rënies së komunizmit*, (Punim Doktorature), fq. 83.

³³ Ibid.

³⁴ E. Topulli, *Besimet fetare në Shqipëri*, (Punim diplome) <http://flurudha.blogspot.com/2014/06/besimet-fetare-ne-shqiperi-punim-diplome.html?m=1>. (marrë më 01/05/2023).

Nismën për ringritjen e Kishës Orthodhokse e mori përsipër Patriarkana Ekumenike, e cila ka për detyrë t'i mbështesë kishat në nevojë. Patriarku Ekumenik, Dhimitri, dhe Sinodi i Shenjtë zgjodhën si Ekzark Patriarkal Anastas Janullatosin. Më pas, 2 gusht 1992, u fronëzua në katedralen e Tiranës si kryepiskop i Tiranës, Durrësit dhe gjithë Shqipërisë në prani të klerikëve dhe laikëve dhe kështu nisën edhe hapat për rigjallërimin e Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë³⁵. Në vitin 1992, u krijua Seminari Theologjik, më pas Akademia Theologjike në Shën Vlash-Durrës, e cila sot i përket Universitetit “Logos”, si degë e tij, ku përgatiten klerikë, theologë, katekistë për aktivitete të ndryshme të kishës. Sot shërbejnë 150 klerikë. U formua Sinodi i Shenjtë, u hirotonis një brez klerikësh të gjithë nënshtetas shqiptarë. Gjithashtu janë ndërtuar qendra rinore në shumë fshatra dhe qytete ku çdo vit organizohen kampe të ndryshme. Kisha ka shtypshkronjën e saj ku çdo muaj boton gazetën e saj “Ngjallja”, revista “Gëzohu”, “Kambanat” dhe “Kërkim”. Në nëntor të vitin 1999 është ndërtuar klinika “Ungjillëzimi” një poliklinikë që ofron shërbime të ndryshme mjekësore. Poliklinika të tjera të Kishës Orthodhokse funksionojnë edhe në: Kavajë, Korçë edhe Jergucat të Gjirokastrës gjithashtu dhe në disa zona rurale. Numri i vizitave deri më sot përkon dy milionë. Në lidhje me arsimin, funksion Departamenti i Theologjisë dhe Kulturës, që i përket Kolegjit Universitar “Logos”, shkolla e mesme kishtare në Gjirokastrë për djem dhe vajza që ndiqen me bursa nga Kryepiskopi, funksionojnë 18 kopshte e disa shkolla të mesme e 9-vjeçare në qytete të ndryshme. Gjithashtu është ndërtuar në Shën Vlash-Durrës, shtëpia e fëmijës “Shtëpia Orthodhokse Shpresa”. Kisha Orthodhokse zhvillon një vepër të gjerë filantropike dhe sociale me anë të sektorit të saj të veçantë “Diakonia Agapes”. Si përfundim, janë ndërtuar 155 kisha të reja, janë restauruar 63 kisha dhe janë riparuar mbi 160 kisha. E tërë vepra ndërtuese arrin 460 objekte³⁶.

Rihapja e aktivitetit islam, pas rënies së komunizmit, u bë në nëntor të vitit 1990 në xhaminë e Plumbit në Shkodër, pas përfundimit të ceremonisë. Në fjalën e hapjes, Hasif Sabri Koçi, që më pas u emërua si kryetari i Komunitetit Mysliman, theksoi nevojën e ushtrimit të besimit në çdo kohë dhe nga çdo njeri. Rihapjet e xhamive që i kishin mbijetuar komunizmit filloi të kryhej me hapa të shpejtë, u hapën salla për të kryer faljen e predikimit në vendet që mungonin xhamitë, gjithashtu filluan të ndërtoheshin edhe xhami të reja³⁷. U hap fillimisht medreseja e mesme në

³⁵ A. Janullatos, *Ringritja e Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë*, Tiranë: 2015, fq. 11.

³⁶ A. Janullatos, *Ringritja e Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë*, Tiranë: 2015, fq. 37-62.

³⁷ 30 vjet nga Rithemelimi i KMSH-së https://dritaislame.al/30-vjet-nga-rithemelimi-i-kmshe-se/?amp#_ftn9. (marrë më 15/06/2023).

qytetin e Tiranës, më pas në qytetin e Shkodrës dhe në vazhdimësi në qytetet Korçë, Kavajë, Berat. Përveç shkollave fetare lindi nevoja edhe e librave fetarë, pra e shtypit fetar. Në janar të vitit 1992, del numri i parë i gazetës “Drita Islame”, më pas me botimin e revistës “Zani i Naltë”. Sot, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë është i shtrirë në 35 qytete të vendit duke numëruar 942 xhami, 4 Medrese në rrethet Tiranë, Durrës, Shkodër, Elbasan si edhe Kolegjin Universitar Beder në Tiranë³⁸.

Më 27 mars 1991, në Tiranë u ngrit një komitet i përkohshëm për ringjalljen e bashkësisë së bektashinjeve. Që prej asaj dite dhe në vazhdimësi, ky komitet ka punuar shumë për të ngjallur traditat e Bektashizmit në Shqipëri. Më 22 mars të vitit 1991, me rastin e festës së Sulltan Novruzit, në Tiranë u rihap teqeja dhe selia botërore. Në Kryegjyshatën Botërore Bektashiane të përruar në shtator të vitit 2015, ndodhet Muzeu Bektashian. Ky muze prezanton nëpërmjet fotografive, dokumenteve të ndryshme, objekteve origjinale historinë e Bektashizmit të përqendruar më tepër te Bektashizmi në Shqipëri. Një kënd i rëndësishëm i këtij muzeu i është dedikuar tolerancës fetare³⁹. Sipas faqes zyrtare të Kryegjyshatës Bektashiane në vitin 2020, numri i teqeve që ajo numëron, është 127⁴⁰.

Që para rënies së komunizmit, Vatikani dërgoi fshehur përfaqësues në vend për të shqyrtuar nga afër situatën. Këta përfaqësues vunë re se kisha katolike ishte në situatë kaotike. Pas persekutimit të ashpër që i bëri fesë komunizmi, kishin mbetur 28 klerikë dhe 42 murgës, që ishin në moshë të thyer. Delegacioni i parë zyrtar i Vatikanit, erdhi në mars të 1991 për të shqyrtuar nga afër gjendjen e Kishës Katolike në Shqipëri, dhe menjëherë nisi organizmi i rindërtimit të Kishës Katolike në Shqipëri. Mesha e parë u kremtua në nëntor të vitit 1991. Në prill të vitit 1993 Papa Gjon Pali II vizitoi Shqipërinë dhe siguroi katër peshkopët e parë të kishës. Misionarë nga vende të ndryshme erdhën për të ndihmuar në rindërtimin e Kishës Katolike në Shqipëri. Këta misionarë u ngarkuan me mbështetjen e qendrave baritore dhe me ndërtimin e kishave. U dha një rëndësi edhe botimit të revistave, periodikëve, u vunë përpjekje për përmirësimin e shëndetësisë. Deri në vitin 1996, Kisha Katolike kishte themeluar dhe rinovuar gjithsej 60 qendra mjekësore. Vëmendje e veçantë u dha edhe arsimit, ku u ndërtuan shkolla, universiteti “Zonja e Këshillit të

³⁸ 30 vjet nga Rithemelimi i KMSH-së https://dritaislame.al/30-vjet-nga-rithemelimi-i-kmshe/?amp#_ftn9. (marrë më 15/06/2023).

³⁹ Objekte Religjose (Harmoni Religjose) <https://tirana.al/pika-interesi/kryegjyshata-boterore-bektashiane>. (marrë më 15/06/2023).

⁴⁰ J. Topulli, *Rigjallërimi i besimeve fetare në Shqipëri pas rënies së komunizmit*, (Punim Doktorature), fq. 84.

Mirë” etj⁴¹. Kisha Katolike, sipas të dhënave të saj, posedon 694 institucione katolike⁴². Numri total i katolikëve i vetëraportuar në numër, arrin afërsisht 16,8% të popullsisë shqiptare⁴³.

Me hapjen e kufijve në vitin 1990-1996, në Shqipëri u regjistruan 120 sekte fetare ku, ndër më të përmendurat, në Shqipëri janë: Dëshmitarët e Jehovait, Mormonët, Bahai⁴⁴. Vëllazëria Ungjillore, sipas të dhënave të saj në faqen zyrtare ka 114 kisha⁴⁵.

Sipas një prej censuseve më të fundit të shqiptarëve të viti 2011, 56,7% e popullsisë janë myslimanë sunitë, 10,3% deklarohen katolikë, 6,75% orthodhoks, 2,9% bektashinj. Gjithashtu 5,49% janë besimtarë të pacilësuar, 13,79% nuk preferojnë të tregojnë përkatësinë e tyre fetare dhe 2,5% deklarohen ateistë⁴⁶.

Komunitetet fetare kundërshtuan të dhënat e censusit në lidhje me përkatësinë fetare të shqiptarëve. Përfaqësuesit myslimanë, të krishterët orthodhoksë dhe bektashinj të reagimet e tyre kanë shprehur të gjithë të njëjtin qëndrim. Arsyeja primare pse ata kundërshtojnë shifrat e nxjerra nga censusi, është lënia jashtë anketimit e një pjese të madhe të popullsisë. Kisha Orthodhokse shprehu se 50% e popullsisë nuk është pyetur fare në lidhje me censusin dhe kurrësi nuk do të pranohet prej tyre 6,75% e popullsisë të jetë orthodhokse, pasi kjo shifër është e papranueshme. Komuniteti Mysliman gjithashtu nuk i pranon këto të dhëna, por i quan ato si aspak shqetësuese për besimtarët myslimanë pasi rritja dhe ulja e shifrave artificialisht nuk do të ketë fitim për askënd. Ata shprehin gjithashtu që, në sondazhe të tjera të realizuara, numri i myslimanëve arrin 70% të popullsisë. Komuniteti Bektashi gjithashtu u shpreh kundër shifrave të censusit. Për ata janë rreth 73 mijë besimtarë që i përkasin këtij komuniteti dhe 30% e tyre nuk janë pyetur fare në anketimin e bërë⁴⁷.

Duke pasur parasysh sfondin historik të feve në Shqipëri, duke përfshirë këtu edhe regjimin komunist, shtrohet çështja se cilat shihen problemet ripohimit të besimit. Së pari, në nivelin juridik,

⁴¹ S. Ritsi, *The Transmission of the Gospel in the Multireligious Society of Albania and the Rediffusion to the Oikoumene*, (Doctoral Thesis), pg. 69-70.

⁴² J. Topulli, *Rigjallërimi i besimeve fetare në Shqipëri pas rënies së komunizmit*, (Punim Doktorature), fq. 84.

⁴³ Ukgjini, *Kisha Katolike: Ukgjini, Nikë. Kisha Katolike në Trevat Shqiptare (Nga Shek. XI deri sot)*. Tiranë, Qendra Botuese Shoqata Jezuitëve, 2017, fq. 389-390.

⁴⁴ E. Topulli, *Besimet fetare në Shqipëri*, (Punim diplome) <http://flurudha.blogspot.com/2014/06/besimet-fetare-ne-shqiperi-punim-diplome.html?mç1>. (marrë më 01/05/2023).

⁴⁵ J. Topulli, *Rigjallërimi i besimeve fetare në Shqipëri pas rënies së komunizmit*, (Punim Doktorature), fq. 84.

⁴⁶ Albaninan Profile, *Besimet Fetare në Shqipëri* <https://thealbanianprofile.com/besimet-fetare-ne-shqiperi/>. (marrë më 17/05/2023).

⁴⁷ Fetë kundër Censusit, bektashinjët: Nuk u pyetëm, “Panorama”, 15 dhjetor 2012 (marrë më 03/07/2023).

Shqipëria ka hyrë në rrugë të re kushtetuese që ka si karakteristikë lirinë e besimit. Është vendosur liria e besimit fetar, e veprimtarisë së institucioneve fetare, e shumë shoqatave të tjera fetare. Shteti nuk mund të ndërhyjë në çështjet fetare dhe çështja e besimit është çështje private që i përket secilit prej individëve të këtij vendi. Shteti shqiptar ka nënshkruar marrëveshje me pesë prej komuniteteve: Orthodhokët, Myslimanët, Katolikët, Bektashinjët dhe Ungjillorët⁴⁸.

Së dyti, në nivelin dogmatik, kemi të bëjmë me larminë e problemeve që i përkasin vetë fesë, ku mësimet e shkrimeve të shenjta bëhen pjesë e pandarë e jetës së besimtarëve. Kjo çështje ka një rëndësi shumë të veçantë, për faktin që edhe pse besimi u ndalua për 30 vjet, roli i tij në jetën morale dhe shpirtërore të njerëzve nuk u ndërpre. Dhe, së treti, në nivelin dogmatik shpirtëror, është që fetë mund të ndikojnë në lartësimin shpirtëror të të gjithë shqiptarëve⁴⁹.

Gjithmonë feja ose religjioni ka ushqyer paqen, ka pasur rol të madh dhe të rëndësishëm në kultivimin e vlerave të jetës, duke përfaqësuar kështu aspirate të larta të jetës njerëzore⁵⁰. Mirëkuptimi, bashkëpunimi dhe toleranca që ekziston midis feve në Shqipëri, përbën një gur të çmuar dhe të rrallë të shqiptarëve.

⁴⁸ Gj. Sinani, *Feja dhe edukimi*, Friedrich Ebert Stiftung, Tiranë 2017, fq. 9.

⁴⁹ Gj. Sinani, *Feja dhe edukimi*, Friedrich Ebert Stiftung, Tiranë 2017, fq. 9.

⁵⁰ Ibid.

Kapitulli i dytë

Takimet midis komuniteteve fetare ndër vite

Në këtë kapitull do të njihemi me krijimin e KNFSH-së (Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë), analizimin e takimeve që janë bërë ndër vite midis këtyre komuniteteve, temat që janë mbajtur dhe nënvizimi i vlerave të mëdha dhe të rëndësishme që ka në vizionin për botën religjioni. Edhe pse vetë KNFSH-ja nuk ka zhvilluar konferenca të drejtpërdrejta, ajo ka qenë pjesë e konferencave ndërkombëtare, të cilat do t'i shohim më poshtë.

Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë është krijuar më 25 tetor 2007 nga krerët e katër komuniteteve fetare më të mëdha në Shqipëri. Kreu i Komunitetit Orthodhoks- Fortlumturia e Tij, Kryepiskopi i Tiranës, Durrësit dhe gjithë Shqipërisë, Anastasi, kreu i Komunitetit Mysliman - H. Selim Muça, kreu i komunitetit Bektashi- Dede Reshat Bardhi dhe kreu i Komunitetit Katolik- Mons. Rrok Mirdita, duke u regjistruar edhe në rrethin e Gjykatës Tiranë. Më pas, më 2008 shtohet edhe komuniteti i pestë me të drejta të barabarta, Vëllazëria Ungjillore⁵¹.

Në ceremoninë e themelimit të KNFSH-së mori pjesë dhe presidenti i atëhershëm Z. Bamir Topi, i cili nënvizoi se toleranca fetare është një vlerë e rrallë, e përbashkët e shqiptarëve që duhet ndarë edhe me popujt e tjerë të botës.

Organi më i lartë vendimmarrës i KNFSH-së është Këshilli i Presidencës, që është i përbërë nga Kryetarët e Komuniteteve Fetare pjesëmarrëse dhe Këshilli Ekzekutiv është i përbërë nga dy anëtarë për çdo komunitet. Kryetari i Këshillit të Presidencës ka një mandat njëvjeçar, pra të gjithë krerët e këtyre komuniteteve qëndrojnë si kryetar një vit dhe kështu me radhë⁵².

KNFSH-ja është nderuar me disa çmime. Më 25 tetor të vitit 2018 është vlerësuar me çmimin “De Mello për të drejtat e njeriut” në Poloni. Ky çmim iu akordua padyshim pesë udhëheqësve kryesorë të komuniteteve fetare për “Vëllazërinë Ndërfetare në Shqipëri”. Ky çmim jepet çdo vit për personalitete që përfaqësojnë kauza të tilla. Më 22 mars 2021 presidenti i asaj kohe, Z. Ilir Meta, u ka dhënë medalje me titullin “Nderi i Kombit” Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë duke i

⁵¹ <https://knfsh.al/en/>. (marrë më 09/05/2023).

⁵² Ibid.

vlerësuar për frymën e harmonisë që provojnë, bashkëjetesës fetare. Dhe, më 17 nëntor 2021, Ministria Federale Austriake për çështjet Evropiane dhe Ndërkombëtare i ka akorduar Këshillit Ndërfetar Shqiptar “çmimin e Mirënjohjes” për ndihmën në kohën e tërmetit ndaj familjeve në nevojë⁵³.

Që nga viti 2007 e deri më sot, KNFSH-ja, përveç pjesëmarrjes në konferenca ndërkombëtare, ajo gjithashtu ka dalë edhe në deklarata të shumta, gjithmonë në promovimin e dialogut ndërfetar⁵⁴.

Konferenca

Siç edhe e përmendëm më sipër, KNFSH-ja ka marrë pjesë në shumë konferenca ndërkombëtare. Le të njihemi me disa prej tyre.

Më 18 dhjetor të vitit 2018, në Rimini të Italisë, është zhvilluar konferenca me temë: “**Rruga Adriatike e Dialogut Ndërfetar**”. Fillimisht, konferenca është përshëndetur nga Ispeshkvi i Dioqezës së Riminit dhe San Marinos, Françesko Lambiasi, si edhe drejtues të institucioneve të ndryshme fetare. Pas fjalimeve, konferenca ka vijuar me seancat shkencore ku sesioni i parë i seancave është mbajtur nga drejtori i Institutit të Lartë të Shkencave Fetare Prof. Natalino Valentini, ndërsa sesioni i dytë nga Prof. Johnny Farabegoli. Në këtë konferencë është referuar në përgjithësi rreth dialogut ndërfetar dhe në veçanti rreth bashkëjetesës ndërfetare në Shqipëri. Si përfaqësues nga Shqipëria ka marrë pjesë sekretari i Këshillit Ndërfetar Dr. Genti Kruja ku foli rreth bashkëjetesës fetare në Shqipëri dhe u ndal edhe te dialogu kristiano-myliman⁵⁵.

Më 3 maj 2018, u organizua konferenca ndërkombëtare nga Universiteti “Logos”, Universiteti “Beder”, Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”, si dhe në bashkëpunim me Ambasadën Austriake të Shqipërisë. Konferenca u mbajt në lidhje me dialogun ndërfetar: “**Shqipëria, Model i Bashkëjetesës Ndërfetare për Evropën**”? Në këtë konferencë morën pjesë theologë nga Evropa dhe Shqipëria, kryetarët e komuniteteve fetare të Shqipërisë, përfaqësues akademikë, klerikë. Konferenca, fillimisht, u përshëndet nga ambasadori i Austrisë në Tiranë Z. Johann Sattler,

⁵³ Ibid.

⁵⁴ Ibid.

⁵⁵ Zhvillohet në Rimini të Italisë Konferenca “Rruga Adriatike e Dialogut Ndërfetar” <https://knfsh.al/en/> (marrë më 09/05/2023).

ministrja e Kulturës Znj. Mirela Kumbaro dhe Nunci Apostolik në Shqipëri Z. Charles John Brown. Në fund të konferencës, kryetarët e komuniteteve fetare nënshkruan deklaratën për angazhimin që ata do të jepnin në lidhje me dialogun ndërfetar në Shqipëri⁵⁶.

Me rastin e 50-vjetorit të themelimit të Organizatës Ndërkombëtare **“Religions for Peace”**, në korrik të vitit 2020 është zhvilluar takim online ndërkombëtar me këshillat fetarë nga e gjithë bota dhe është mbajtur diskutim në lidhje me rritjen e gjithëpërfshirjes në këshillat ndërfetarë. Takimi është zhvilluar online për shkak të pandemisë botërore Covid-19. Si përfaqësues nga Shqipëria dhe për të ndarë eksperiencën e dialogut ndërfetar që ekziston në këtë vend, ishte sekretari i Përgjithshëm i KNFSH-së, Dr. Genti Kruja, i cili foli mbi historikun e harmonisë fetare në Shqipëri, bashkëpunimin që kanë këto komunitete përgjatë disa viteve, pjesëmarrjen e të rinjve, grave në këto aktivitete nga komunitete të ndryshme. Gjithashtu, një fjalim mbajti dhe Zv./Kryetari i Përgjithshëm Z. Kyoichi Sugino, Këshilli Fetar i Shqipërisë u paraqiti si një model i një institucioni aktiv ku të gjitha komunitetet fetare shqiptare janë të përfaqësuara në mënyrë të barabartë. Dr. Kruja foli më gjerësisht për këtë çështje të dialogut që ekziston midis komuniteteve duke dhënë shembuj konkretë⁵⁷.

Më 8 shkurt të vitit 2021, Caritasi Shqiptar, në bashkëpunim me Këshillin Ndërfetar të Shqipërisë, organizuan konferencë kombëtare me temë: **“Besimet fetare kundër trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri”**, dhe u zhvillua në sallën e konferencave të Universitetit Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”, në Tiranë. Në këtë konferencë morën pjesë përfaqësues nga komunitetet fetare ku mbajtën kumtesat e tyre, si: H. Bujar Spahiu, kryetar i komunitetit Mysliman të Shqipërisë. Atë Grigor Pelushi, përfaqësues i Kishës Orthodhokse të Shqipërisë, H. Dede Edmond Brahimaj Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve, Pastor Ylli Doçi, kryetar i Vëllazërisë Ungjillore të Shqipërisë dhe Mons. Angelo Massafra Arqipeshkëv i metropolit Shkodër-Pult. Qëllimi i kësaj konference ishte prezantimi i situatës së trafikimit të qenieve njerëzore në vendin tonë, qëndrimet që mbante çdo komunitet fetar në Shqipëri kundër këtij fenomeni, si edhe bashkëpunimi dhe forcimi i komuniteteve fetare në këtë bashkëpunim. Në këtë konferencë, përveç përfaqësuesve të

⁵⁶ Zhvillohet Konferenca Ndërkombëtare mbi Dialogun Ndërfetar ICID <https://knfsh.al/en/> (marrë më 09/05/2023).

⁵⁷ KNFSH pjesë aktive e panelit ndërkombëtar të “Religions For Peace” <https://knfsh.al/en/> (marrë më 09/05/2023).

komuniteteve fetare, morën pjesë edhe përfaqësues të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, përfaqësues nga ambasada e SHBA-së në Tiranë⁵⁸.

Më datat 3-7 nëntor të vitit 2021, është zhvilluar në Lindau të Gjermanisë, Konferenca Ndërkombëtare e Këshillit Botëror mbi besimin dhe Diplomacinë me temë **“Brezat në Dialog”**. Kjo konferencë është mbajtur online për shkak të pandemisë dhe masave të mara ndaj Covidit - 19. Kanë qenë shumë përfaqësues, si: Këshillat Ndërfetarë nga shtete të ndryshme, institucione qeveritare, organizata të paqes dhe dialogut nga gjithë bota dhe përfaqësues nga bota akademike. I ftuar si përfaqësues i Shqipërisë ishte Dr. Genti Kruja, i cili është Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit Ndërfetar, i cili mbajti një kumtesë në lidhje me humanizmin që kanë treguar komunitetet fetare gjatë çështjes së pandemisë. Si fillim, ai preku si temë dialogun ndërfetar që ekziston në Shqipëri dhe më pas u ndal te ndihma humanitare që kanë treguar komunitetet si në çështjen e tërmetit të fundvitit 2019, ku shumë të rinj myslimanë e të krishterë ndihmuan në mënyrë vullnetare në shpërndarjen e ndihmave në disa qytete⁵⁹.

Më 30 dhe 31 tetor të vitin 2021, është zhvilluar një forum ndërfetar në qytetin e Pogradecit, që u zhvillua nga Këshilli Ndërfetar, me përfaqësues nga Departamenti i Gruas gjithashtu dhe përfaqësues të Departamentit të Rinisë të KNFSH-së. Gjatë kësaj konference u zhvilluan edhe vizita në institucione të ndryshme fetare të Pogradecit. Fillimisht, në takim është organizuar një workshop, ku përfaqësues të rinj të komuniteteve të ndryshme fetare kanë dalë me disa rezultate dhe konkluzione të ndryshme, të cilat i kanë prezantuar përpara auditorit. Gjetjet e tyre nënvizonin faktin që institucionet fetare kanë rol të rëndësishëm në promovimin e vlerave të rinjtë, jo gjuhën e urrejtjes, promovimin e dashurisë etj. Siç edhe e përmendëm më sipër, gjatë këtij takimi u zhvilluan edhe vizita në objekte kulti të komuniteteve të ndryshme fetare, si: Kisha Orthodhokse “Ngjallja e Krishtit”, Xhamia “Ebu Bekr”, shkolla “Amaro Tan” e Ungjillorëve⁶⁰.

Më 22 nëntor 2021, Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë në bashkëpunim me Qendrën CVE ka organizuar forumin ndërfetar me temë: **“Roli i liderëve fetarë dhe i rinisë në parandalimin e ekstremizmit dhe radikalizimit”**. Pjesëmarrës në këtë forum ishin: liderit e komuniteteve fetare,

⁵⁸ Zhvillohet Konferenca Kombëtare: “Besimet Fetare Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore në Shqipëri” <https://knfsh.al/en/> (marrë më 09/05/2023).

⁵⁹ Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë pjesëmarrës në Konferencën Ndërkombëtare në Gjermani <https://knfsh.al/en/> (marrë më 09/05/2023).

⁶⁰ Pogradec, zhvillohet forumi ndërfetar me Departamentin e Gruas dhe Rinisë në KNFSH <https://knfsh.al/en/> (marrë më 09/05/2023).

anëtarët e Bordit të Presidencës së KNFSH-së, përfaqësues nga ambasada e SHBA-së, anëtarë të bordit ekzekutiv, të departamentit të rinisë dhe gruas, ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar SHTZ. Alastair King-Smith, përfaqësues të delegacionit të lartë të organizatës ndërkombëtare The Global Community Engagement and Resilience Fund, që ka qendrën në Zvicër, i kryesuar nga Z. Kevin Osborne. Fillimisht, ky forum u përshëndet nga lideri kryesor i komuniteteve fetare të Shqipërisë, ku lideri u ndalën rreth punës dhe kontributit të komuniteteve fetare në promovimin e paqes dhe dialogut dhe edukimit të brezave të sotëm për të qëndruar larg çdo ekstremizmi dhe radikalizimi në çdo lloj forme⁶¹.

Më 24 nëntor 2021, u zhvillua simpoziumi ndërkombëtar i organizuar nga Ministria e Jashtme në Austri në bashkëpunim me Universitetin e Vjenës dhe Fondacionin Anna Lindh me temë: **“Best practices in Intercultural and Interreligious Dialogue Initiatives”**. Ky simpoziум u zhvillua në mënyrë hibride për shkak të masave të marra nga pandemia botërore COVID-19. I ftuar në këtë simpoziум ishte Sekretari i Përgjithshëm i KNFSH-së Dr. Genti Kruja ku ndau me kolegë nga vende të ndryshme të botës kontributin e Shqipërisë në dialogun ndërfetar⁶².

Më 17 dhjetor 2021, Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë, në bashkëpunim me qendrën ndërfetare në Elbasan, kanë organizuar forumin ndërfetar me temë: **“Roli i Rinisë dhe Gruas Ndërfetare në parandalimin e ekstremizmit dhe radikalizimit”**. Pjesëmarrës në këtë forum ishin: drejtues të Këshillit Ndërfetar të vendit tonë, lider të komuniteteve fetare të qytetit të Elbasanit si edhe anëtarë të Departamentit të Rinisë dhe Gruas në Këshillin Ndërfetar. Forumi është hapur me fjalën përshëndetëse të kryetarit të KNFSH-së H. Dede Edmond Brahimaj dhe më pas ka vijuar nga përfaqësuesit e tjerë. Dr. Genti Kruja, i cili është Sekretar i Përgjithshëm i KNFSH-së, ka theksuar rolin e institucioneve fetare dhe jo vetëm fetare, por edhe të atyre akademike në promovimin e dialogut ndërfetar për brezat e rinj të theologëve të gjitha komuniteteve fetare. Në fund të forumit, pjesëmarrësit kanë folur në lidhje me rolin që kanë të rinjtë dhe gratë në parandalimin e radikalizimit dhe ekstremizmit⁶³.

⁶¹ KNFSH zhvillon forumin ndërfetar mbi rolin e liderëve fetarë dhe rinisë në parandalimin e ekstremizmit dhe radikalizimit <https://knfsh.al/en/> (marrë më 09/05/2023).

⁶² KNFSH pjesë në simpoziumin ndërkombëtar organizuar nga Ministria e Jashtme e Austrisë <https://knfsh.al/en/> (marrë më 09/05/2023).

⁶³ KNFSH zhvillon forum ndërfetar në Elbasan <https://knfsh.al/en/> (marrë më 09/05/2023).

Më 10 shkurt 2022, Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë, në bashkëpunim me Këshillat Ndërfetare të Evropës ka organizuar konferencën ndërfetare dhe ndërkombëtare me temë: **“Vëllazëria në Humanizëm”**. Në këtë konferencë morën pjesë: liderit e komuniteteve fetare të vendit tonë, ambasadorja e SHBA-së në Tiranë SHTZ. Yuri Kim, Nuncit Apostolik SHTZ. Luigi Bonazzi si dhe presidentët e Këshillave Ndërfetare të Evropës. Gjithashtu morën pjesë edhe theologë, klerikë studiues, intelektualë si edhe të rinj dhe të reja nga të gjitha komunitetet fetare. Seanca e parë e moderuar nga Dr. Genti Kruja, Sekretar i Përgjithshëm i KNFSH-së, i cili theksoi që edhe pse bota në ditët e sotme ka kulmin e zhvillimit të saj si nga ana ekonomike dhe teknologjike, përsëri shumë vende vuajnë akoma nga varfëria, korrupsioni, urrejtja etj. Edhe pse në këto kohëra nuk mungojnë përpjekjet për dialog dhe bashkëpunim, si nga shtete dhe organizma botërorë edhe nga liderë botërorë të besimeve të ndryshme fetare. Më pas, Dr. Kruja bëri një pasqyrim të aktiviteteve të Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë. Pas kësaj, të gjithë kryetarët mbajtën fjalime. Kryetari i Komunitetit Mysliman, H. Bujar Spahiu, në fjalën e tij bëri apel në lidhje me politikën që duhet t’i kushtojë më tepër rëndësi arsimit, media të nxisë më shumë frymë paqe duke pasur një rol edukues ndërsa besimtarët dhe qytetarët në lidhje me teknologjinë ta përdorin këtë të fundit për qëllime të mira dhe jo të bien pre e manipulimit, urrejtjes, përçarjes dhe dhunës verbale. Kryepiskopi i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, Fortlumturia e tij Anastas Janullatos, cilësoi se dekadave të fundit, në Shqipëri, ka pasur kriza të brendshme dhe komunitetet fetare u bashkuan për t’i ardhur në ndihmë. Vizioni ynë nuk është vetëm toleranca fetare, por, e shtrirë më gjerë, bashkekzistenca harmonike. Kryetari i Vëllazërisë Ungjillore dhe kryetari i KNFSH-së për vitin 2022, Pastor Ylli Doçi, në fjalën e tij vlerësoi tolerancën fetare në vendin tonë që është burim i traditës së shqiptarëve. Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve H. Dede Edmond Brahimaj tha se vendi ynë, edhe pse ka kaluar ngjarje të vështira si komunizmi, ka diçka të bukur brenda vetes, gurin e çmuar të harmonisë fetare. Ambasadorja e SHBA-së, Yuri Kim, e ka vlerësuar KNFSH-në duke theksuar që Shqipëria mund të shihet si një lider botëror në lidhje me harmoninë ndërfetare dhe lirinë fetare që ekziston. Më pas, konferenca ka vijuar me fjalime dhe nga pjesëmarrësit e tjerë ku është shquar dhe vlerësuar roli i rëndësishëm që ka toleranca në vendin tonë⁶⁴.

Më 27 mars 2022, Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë organizoi një forum ndërfetar në qytetin e Gjirokastrës, me pjesëmarrjen e drejtuesve të Këshillit Ndërfetar të vendit tonë, përfaqësues të

⁶⁴ Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë Organizon Konferencën Ndërkombëtare dhe Ndërfetare “Vëllazëria në Humanizëm” <https://knfsh.al/en/> (marrë më 09/05/2023).

komuniteteve fetare të qarkut të Gjirokastrës, anëtarë të departamentit të Rinisë dhe Gruas, si edhe anëtarë të bordit ekzekutiv. Ky forum është hapur fillimisht me fjalën përshëndetëse të kryetarit të KNFSH-së, Ylli Doçi, i cili u ndal në shpjegimin e dialogut ndërfaqetor dhe më pas Dr. Genti Kruja foli në lidhje me rolin që duhet të kenë institucionet fetare dhe ato akademike të komuniteteve fetare në promovimin e dialogut ndërfaqetor për brezat e rinj. Më pas u diskutua nga të rinjtë rëndësia e aktiviteteve për promovimin e dialogut dhe humanizmit⁶⁵.

Deklarata

Përveç marrjes pjesë në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, me të cilat u njohëm dhe i analizuam më sipër, KNFSH-ja ka dalë gjithashtu në deklaratë të ndryshme lidhur me situatën e ndryshme. Le t'i shqyrtojmë dhe le t'i analizojmë si më poshtë.

Më 27 shkurt 2019, Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë ka mbajtur një *deklaratë për shtyp lidhur me situatën politike* që po ndodh në këtë vend. KNFSH-ja ndoqi me shqetësim situatën politike në vend, e cila ka ndikim të madh në zhvillimin ekonomik, social e rinisë së këtij vendi në të ardhmen dhe kështu krijon një situatë të pasigurt dhe humb shpresën e këtij populli. Këshilli Ndërfetar i bëri thirrje politikës shqiptare për dialog dhe për zgjidhje të konfliktualitetit, e cila thellon më tepër varfërinë e shqiptarëve. KNFSH-ja doli me thirrjen për shpresën dhe lënien pas të dhunës verbale apo fizike dhe arriti në një zgjidhje, në dobi të popullit të vuajtur dhe rinisë së këtij vendi që meriton një të ardhme të mirë⁶⁶.

Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë dënon ashpër sulmin që ndodhi në Zelandën e Re, ku 49 persona, besimtarë myslimanë, humbën jetën duke u falur në xhami, ndërsa 50 persona të tjerë ngelën të lënduar. KNFSH-ja doli në deklaratë duke theksuar që ky akt barbar dhe mizor tregon se terrori nuk ka fe dhe godet këdo me mizorinë e tij. Gjithashtu, Këshilli shprehu solidaritetin e tij në lidhje me viktimat, familjarët duke i kujtuar ato në lutjet dhe në afërsinë shpirtërore⁶⁷.

Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë shpreh pikëllimin dhe ngushëllimin e thellë, për 300 njerëz që humbën jetën nga sulmet terroriste në mëngjesin e Pashkës gjatë lutjes së tyre në dy kisha katolike

⁶⁵ KNFSH zhvillon Forumin Ndërfetar në Gjirokastrë <https://knfsh.al/en/> (marrë më 09/05/2023).

⁶⁶ Deklaratë për shtyp lidhurën me situatën politike <https://knfsh.al/en/> (marrë më 09/05/2023).

⁶⁷ Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë: Dënojmë ashpër çdo formë terrori që godet humanizmin <https://knfsh.al/en/> (marrë më 09/05/2023).

dhe një ungjillore, në qytetet e Sri Lankës si edhe në hotele. KNFSH-ja doli në deklaratë që dënon çdo lloj terrori, dhune duke shprehur ngushëllimet e tyre dhe lutjet për paqe e bashkëjetesë pa dallim race, ngjyre dhe feje⁶⁸.

Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë, për herë të parë në historinë e vendit tonë, ka zhvilluar konsultimet kombëtare të Këshillit të Presidencës, Departamentit të Gruas dhe Rinisë dhe Bordit Ekzekutiv gjithashtu ka dalë dhe me rekomandime të rëndësishme. Departamenti i Gruas dhe Rinisë janë krijuar në mbledhjen e zhvilluar të Këshillit të Presidencës në prill 2019 dhe në 20 qershor të po këtij viti janë mbledhur për herë të parë duke dhënë propozime dhe ide të vlefshme. Në 27 qershor të vitit 2019 janë mbledhur për herë të parë të gjitha bordet dhe departamentet e KNFSH-së, ku janë lexuar ide dhe sugjerime të ndryshme⁶⁹.

Komiteti i Lartë i Vëllazërisë Njerëzore, i cili është themeluar pas takimit historik që u mbajt më 4 shkurt 2019 midis Papa Françeskut dhe Imamit të Madh, Shejhun e Ez'herit Prof. Dr. Ahmed el Tajjib, për të firmosur Dokumentin midis Vëllazërisë Njerëzore. Ky komitet i ka propozuar Papa Françeskut, që më 14 maj 2021, që të gjitha besimet e ndryshme fetare të mblidheshin bashkë në një ditë lutje, bamirësie dhe agjërimi për kapërcimin e pandemisë botërore Coronavirus. Kësaj thirrjeje u bashkangjit edhe Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë ku nxiti të gjithë besimtarët e krishterë, myslimanë e gjithë të tjerët në Shqipëri, që në datën 14 maj, për t'u bashkuar në këtë lutje. Organizata e Kombeve të Bashkuara e mikprititi këtë fushatë dhe, më pas, shtete të tjera iu bashkëngjitën fushatës, si edhe president e qeveri të shteteve të botës⁷⁰.

Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë ka ndjekur, me shumë shqetësim, zhvillimin e fundit politik që ka të bëjë me importin e armëve kimike dhe shkatërrimin e tyre në vendin tonë. KNFSH-ja ka dalë në deklaratë duke nënvizuar faktin që Shqipëria është një vend i bekuar mjaftueshëm nga Zoti dhe prej vitesh është duke vuajtur nga shfrytëzimi dhe shkatërrimi i sipërfaqeve pyjore, ujore, ndotja e tokës dhe e ajrit. Dhe, në lidhje me këto shkatërime, nuk janë marrë masa dhe ndërjegjësimi i qytetarëve gjithmonë lë shumë për të dëshiruar. Gjithashtu, përmendim edhe çështjen e Gërdecit fabrika e demontimit të armëve ushtarake shumë afër Tiranës. Ndaj KNFSH-ja, me të drejtë nga

⁶⁸ Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë: Dhimbje dhe lutje për Sri Lankën <https://knfsh.al/en/> (marrë më 09/05/2023).

⁶⁹ Rekomandimet Kryesore të Konsultimeve Kombëtare të Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë <https://knfsh.al/en/> (marrë më 09/05/2023).

⁷⁰ Myslimanë e të Krishterë Lutje, Agjërime dhe Bamirësi drejtuar Zotit <https://knfsh.al/en/> (marrë më 09/05/2023).

shoqëria civile, i kërkon shtetit shqiptar, autoriteteve, politikanëve që të refuzojnë pranimin e armëve kimike dhe shkatërrimin e tyre në Shqipërinë tonë⁷¹.

Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë, në një letër të përbashkët, i bënë apel kancelares gjermane Znj. Merkel dhe Presidentit francez z. Macron që të mbështesin hapjen e negociatave për anëtarësimin e vendit tonë në Bashkimin Evropian. Letra iu dorëzua nga drejtuesit e këtyre komuniteteve ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme Z. Ditmir Bushati⁷².

Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë, me në krye drejtuesit e komuniteteve fetare, shprehin shqetësim për zhvillimet e fundit të krijuara në vendin tonë, për mungesën e dialogut për zgjidhjen e situatave të krijuara. Gjithashtu shprehin shqetësim për fjalën e dhunshme që shprehin politikanët nëpërmjet mediave sociale dhe të prodhimit të lëndëve narkotike. KNFSH-ja i fton të gjithë politikanët si edhe opozitën të ndryshojnë mënyrën e komunikimit midis njëri-tjetrit, duke krijuar ura dhe jo mure. Gjuha e dhunshme gjithmonë sjell përçarje dhe nxit gjakrat, duke kaluar edhe në veprime të dhunshme. Gjithashtu, drejtuesit e komuniteteve fetare iu bëjnë thirrje edhe qytetarëve që të mos shesin votën e tyre duke qenë të kërcënuar në lidhje me vendin e punës. Ata kërkojnë që të shmangët në çdo lloj forme dhuna ndaj njerëzve, institucioneve dhe objekteve⁷³.

Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë ka dalë në deklaratë ku dënon ashpër krimet që po kryhen nga ISIS në Irak. Bashkësitë fetare gjithashtu i bëjnë apel Faktorit Ndërkombëtar që të gjejë zgjidhje që ky fenomen të ndalojë menjëherë. KNFSH-ja shpreh solidaritetin e saj me të gjithë ata që po e vuajnë këtë fenomen, duke përfshirë këtu Irakun dhe Lindjen e Mesme⁷⁴.

Komunitetet Fetare në Shqipëri kanë dalë në një deklaratë të përbashkët me Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për koordinimin e veprimeve dhe barazinë gjinore dhe kundër dhunës në familje dhe ndaj grave. Në këtë deklaratë, KNFSH-ja është shprehur se promovon vlerat e një familjeje të shëndoshë ku bashkëshortja dhe fëmijët nuk dhunohen, por shihen me dashuri,

⁷¹ Deklaratë për shtyp lidhur me armët kimike <https://knfsh.al/en/> (marrë më 09/05/2023).

⁷² Krerët e Bashkësive Fetare Apel Gjermanisë dhe Francës për Hapjen e Negociatave <https://knfsh.al/en/> (marrë më 09/05/2023).

⁷³ Komunitetet Fetare, Thirrje për Qetësi: Dialogoni, jo dhunë <https://knfsh.al/en/> (marrë më 09/05/2023).

⁷⁴ Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë dënon me forcë krimet e ISIS <https://knfsh.al/en/> (marrë më 09/05/2023).

ku dhe të moshuarit trajtohen me kujdes dhe respekt. Pra, në familje përcillet barazi, dinjitet, harmoni dhe tolerancë. Veprimet kundër dhunës në familje, janë veprime drejt paqes në shoqëri⁷⁵.

Departamenti i Rinisë në Këshillin Ndërfetar të Shqipërisë humbi një nga anëtarët e tij, Xhontil Bardhin. Sekretari i Përgjithshëm i KNFSH-së, Dr. Genti Kruja, ka dalë në deklaratë ku shpreh ngushëllimet dhe dhimbjen e thellë për humbjen tragjike të të riut, ku kjo ngjarje ka plagosur gjithashtu shpresat e të rinjve në vendin tonë në lidhje me klimën e rëndë të krimit⁷⁶.

Kryetari i Këshillit Ndërfetar si edhe Presidenti i Konferencës Ipeshkvnore të Shqipërisë, Mons. George Fredo, doli në një deklaratë në lidhje me lajmin që ishte përfolur shumë kohët e fundit. Pra, për dy gra që u gjetën të vdekura në shtëpinë e tyre, madje ku njëra qëndronte më tepër se një vit e vdekur e mbajtur në shtëpi. Lidhur me këtë çështje, ai doli në deklaratë ku cilësoi se besojmë në jetën pas vdekjes dhe në ngjalljen. Besimi që ne kemi në ngjallje, na ngarkon me më tepër përgjegjësi se si duhet ta jetojmë jetën përderisa jemi në tokë. Jeta është një dhuratë nga Zoti dhe, si një dhuratë, duhet të përdoret me shumë maturi, dhe kjo do të thotë që askush të mos bëjë vetëvrasje dhe të mos ia marrë jetën askujt tjetër. Gjithashtu, ai theksoi që, me kishën Ungjillore, është bërë padrejtësi nga mediat, kur i kanë identifikuar ata me sektin e Jehovait. Dëshmitarët e Jehovait e përdorin Biblën, por e interpretojnë në kundërshtim me kishën⁷⁷.

Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve i cili është dhe Kryetar i Këshillit Ndërfetar iu bënë thirrje të gjithë njerëzve të marrin pjesë në votime. Kryegjyshi nënvizoi se pjesëmarrja në votime është përgjegjësi morale dhe qytetare. Votimi i jep mundësinë çdo individ të ndikojë në ndryshimin e komunitetit ku jeton. Ndaj të gjithë, që nga të rinjtë dhe në vazhdimësi, duhet të shkojnë të votojnë⁷⁸.

Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë i ka dërguar një kërkesë Kuvendit të Shqipërisë, për të marrë pjesë në seancat e Komisionit të Ligjeve, ku do të diskutohet për ndryshimet në Kodin e Familjes. Përveç kërkesës për pjesëmarrje në Komision, KNFSH-ja ka depozituar edhe disa ndryshime në Kodin e Familjes për nenet 241, 242. Propozimi që dërgoi KNFSH-ja në lidhje me nenin 241, është

⁷⁵ Deklaratë e përbashkët për veprime të koordinuara në luftën kundër dhunës ndaj gruas dhe dhunës në familje <https://knfsh.al/en/> (marrë më 09/05/2023).

⁷⁶ Ngushëllim për humbjen e jetës së një prej anëtarëve të Departamentit të Rinisë në KNFSH <https://knfsh.al/en/> (marrë më 09/05/2023).

⁷⁷ Ngjallja, “Vetëfljimi”, Kishat dhe Sektet <https://knfsh.al/en/> (marrë më 09/05/2023).

⁷⁸ Thirrje për pjesëmarrje në votime <https://knfsh.al/en/> (marrë më 09/05/2023).

rritja e moshës së birësuesit, ku mosha aktuale është 21 vjeç. Propozimi ishte që mosha të bëhet 35 vjeç dhe, në raste të veçanta, të lejohet 30 vjeç. Propozimi në lidhje me nenin 242, është që një i mitur të birësohet nga persona që kanë martesë ose bashkëjetesë dhe që kanë bashkëjetuar në mënyrë të vazhdueshme për tre vjet⁷⁹.

Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë është njohur nga Vëllazëria Ungjillore për hapjen e një procedure nga Komisionari për Mbrojtjen kundër Diskriminimit ndaj një Pastori të VUSH-së, për përdorimin, sipas tij, të një gjuhe urrejtjeje. KNFSH-ja shpreh keqardhjen për keqkuptimin që është marrë gjatë fjalës së pastorit, duke qenë se ai i përket një komuniteti të caktuar fetar dhe shpreh bindjen dhe besimin e tij, bazuar në mësimet e tij fetare. Dhe, nëse një përfaqësues i një besimi fetar flet në përputhje me librat e shenjtë, që interpretojnë komunitetet fetare në Shqipëri, kjo nuk mund të konsiderohet gjuhë urrejtjeje. KNFSH-ja shpreh dëshirën që ky problem të qartësohet në lidhje me shprehjen e mendimit hapur për besimin fetar. Komunitet tona në Shqipëri janë institucionet më të vjetra në Shqipëri dhe gjithmonë janë ruajtëse të vlerave universale, harmonisë dhe bashkëjetesës ndërfetare, gjithmonë afër paqes dhe larg çdo gjuhe urrejtjeje⁸⁰.

Pesë komunitetet fetare përbërëse të Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë ndoqën me shumë dhimbje luftën e Rusisë ndaj Ukrainës, duke dalë në një deklaratë për shtyp. KNFSH-ja dënon me forcë dhunën dhe gjakderdhjen e shumë fëmijëve dhe njerëzve të pafajshëm që ka prekur çdo njeri. Këto ngjarje lufte dhe dhune tregojnë që paqja, që është edhe simbol i besimeve tona fetare, duhet të ruhet nga të gjithë ne si një vlerë e çmuar që duhet të promovohet. Lutemi pa fund për popullin e Ukrainës dhe u kërkohet të gjitha komuniteteve ndërkombëtare të angazhohen me çdo mjet që të arrihet armëpushimi⁸¹.

Siç e pamë, KNFSH-ja dhe krijimi i saj kanë pasur një impakt pozitiv të njerëzimit, por edhe më gjerë. Pjesëmarrja në konferenca ndërkombëtare, krijimi i Departamentit të Gruas, Rinisë, forumet e zhvilluara në qytete të ndryshme dhe diskutimet e vazhdueshme në lidhje me rëndësinë që ka feja në promovimin e dashurisë, jo gjuhës së urrejtjes, në promovimin e ndihmës ndaj njëri-tjetrit, në promovimin e kulturës, edukimit, vlerave të njerëzve dhe bashkëjetesës fetare janë

⁷⁹ Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë dërgon propozime në Kuvend për ndryshimet në Kodin e Familjes <https://knfsh.al/en/> (marrë më 09/05/2023).

⁸⁰ Deklaratë <https://knfsh.al/en/> (marrë më 09/05/2023).

⁸¹ Deklaratë për shtyp në lidhje me situatën në Ukrainë <https://knfsh.al/en/> (marrë më 09/05/2023).

përdorur gjerësisht. Krijimi i KNFSH-së, konferencat e mbajtura, deklaratat e shumta në lidhje me situata të ndryshme në Shqipëri dhe jashtë saj na tregojnë qartë dhe pastër se toleranca fetare midis komuniteteve kryesore të feve ekziston dhe është e pranishme në Shqipëri.

Kapitulli i tretë

Toleranca fetare - mit apo e vërtetë?

Në dy kapitujt e mëparshëm u njohëm me ardhjen e religjioneve kryesore në vendin tonë, me vështirësitë e shkatërrimit më pas me ringritjen dhe me krijimin e KNFSH-së (Këshillit Ndërfetar Shqiptar) dhe me të gjitha konferencat dhe deklaratat e mbajtura që prej vitit të krijimit e deri më tani. Në këtë kapitull, i cili është më tepër një kapitull që i referohet intervistave, do të njihemi më shumë me tolerancën dhe me mënyrën si shihet ajo nga populli shqiptar. Sa prej tyre e besojnë dhe e ndiejnë brenda vetes këtë tolerancë? A ekziston vërtet apo është një mit i ngelur nga tradita e këtij vendi.

Fillimisht, le të kuptojmë më tepër mbi termin “tolerancë fetare” dhe kuptimin e nocionit të tij. “Tolerancë fetare është aftësia për të respektuar besimet dhe praktikat fetare të të tjerëve, edhe kur ato janë të ndryshme nga tuajat. Si e tillë, toleranca fetare është një virtyt moral, që përbën respekt për integritetin njerëzor dhe shpirtëror të tjetrit drejt ideve, praktikave dhe besimeve të tyre, pavarësisht nëse ato janë në kundërshtim me tonat”⁸².

Në shumë konferenca dhe takime që janë zhvilluar, është vënë re mjaftueshëm toleranca fetare që ekziston në Shqipëri, siç e pamë edhe në kapitullin më sipër. Toleranca fetare shihet si një vlerë e shoqërisë shqiptare, e cila është zhvilluar dhe ruajtur me kalimin e viteve. Ajo që pranohet, është se kjo tolerancë është rezultat i faktorëve historikë dhe i veprimtarisë së patriotëve shqiptarë që vunë si prioritet identitetin kombëtar⁸³. Për të treguar frymën e tolerancës te populli shqiptar, do të ndajmë disa perspektiva të autorëve të huaj në lidhje me këtë çështje⁸⁴.

Sir Charles Eliot, në fillim të shekullit të kaluar, ka shkruar: *“Shqiptarët kanë një antipati natyrore ndaj bindjes, si në sferën shpirtërore dhe atë temporale. Në kohën e pushtimit turk, nominalisht ata ishin të krishterë, megjithëse, nga numri i zakoneve pagane, të cilat ende mbijetojnë në dasmat e tyre, funeralet dhe ceremoni të tjera, mund të supozohet se konvertimi i tyre ishte vetëm artificial. Për pasojë, ata dallohen në përqaftimin e Islamit më shpejt se ndonjë*

⁸² <https://sq.earbletoncouncil.org/tolerancia-religiosa-2238> (marrë më 11/06/2023).

⁸³ Sir Charles Eliot, *Turkey in Europe*, Edward Arnold, London, 1908, pg:354-355.

⁸⁴ Ibid.

racë tjetër evropiane. Ky ndryshim i besimit ndodhi kryesisht në dy epoka: së pari, menjëherë pas pushtimit dhe, së dyti, në shekullin XVII, kur ndodhi një apostazi e gjerë për shkak të faktit se hapej një karrierë e mirë për myslimanët evropianë në këtë periudhë. Por edhe në shekullin e tanishëm, fise dhe fshatra e kanë ndryshuar fenë për shkaqe fare të vogla. Sipas historisë, pjesë të një fisi të krishterë u bënë muhamedanë sepse prifti i tyre, i cili shërbente në disa fshatra dhe i vizitonte ato së pari, insistuan mbi thënien e meshës në një orë të paarsyeshme. Në tërësi, veriorët kanë qenë më besimtarë ndaj Krishterimit se jugorët, me gjasë sepse ata lejoheshin të mbanin armë. Në ditët tona, të krishterët ndërmjet toskëve të Kishës Orthodhokse, por edhe në veri shumë praktika të pashkës thuhet se ende vëzhgohen, të tilla, si sakramenti i eukaristisë së laikëve në dy lloje. Kisha Katolike Romane në Shqipëri është nën mbrojtjen e Austrisë dhe jo të Francës, si në pjesët e tjera të Turqisë. Shenjat e jashtme të Islamit janë të pakta; xhamitë janë të rralla, vera pihet haptazi dhe praktikohet betimi mysliman përmes virgjërshës... Shumica e myslimanëve shqiptarë i përkasin dervishëve bektashi, të cilët, pavarësisht nga fakti se zyrtarisht lidhen me qeverinë turke përmes jeniçerëve, janë një nga sektet muhamedanë më pak orthodhokë dhe thuhet se mësojnë në mënyrë sekrete, jo vetëm panteizmin, por edhe doktrinën se nuk ka perceptime morale që ndalojnë zgjedhjen”⁸⁵.

Swire, kundër atyre që identifikonin fenë me kombin, shkruante: “Shqiptari nuk është fanatik fetar. Për të, feja nuk nënkupton nacionalitet; dhe progresi drejt realizimit të aspiratës së tij kombëtare ka qenë penguar në një masë të madhe nga paaftësia e botës për të kapur faktin se një mysliman shqiptar nuk është aspak një turk”⁸⁶.

Në lidhje me tolerancën dhe respektimin e fesë së tjetrit, Jacques Bourcart në librin “Shqipëria dhe shqiptarët”, shkruan: “Kalorësit që më shoqëronin, më habitnin gjithnjë kur kujdeseshin për vendet e shenjta dhe për faltoret e çdo feje dhe kur tregonin të njëjtin përgjërimit për të tërë njerëzit e shenjtë katolikë, ortodokë, myslimanë synitë ose bektashi. Dhe, nën këtë vernik fetar aq të ndryshëm përmbledheshin të tëra besimet e lashta: betimet për zjarrin, për ujin ose për malet; frika e vetvetishme nga shpellat ose nga pyjet ku banonin orët dashakeqe ose shtrigat. Shumë nga vendet ku sot gjenden faltore të krishtera ose teqe, janë vende të shenjta shumë më të vjetra”⁸⁷.

⁸⁵ Sir Charles Eliot, *Turkey in Europe*, Edward Arnold, London, 1908, pg:354-355.

⁸⁶ J. Swire, *Albania the Rise of a Kingdom*, Arno Press & the New York Time, New York 1971, pg.39.

⁸⁷ J. Bourcart, *Shqipëria dhe shqiptarët*, Dituria, Tiranë, 2004, fq.53.

Këto pohime nga shumë mendimtarë të ndryshëm shqiptarë dhe të huaj më tepër bashkohen në pikën e tolerancës fetare shembullore nëpërmjet shqiptarëve, gjithashtu rrjedh si kulturë e këtij nacionaliteti dhe ka ngelur në këtë vend nga respekti, morali që bashkon këtë komb për njëri-tjetrin.

Për të kuptuar dhe hulumtuar më tepër në lidhje me lirinë e besimit, harmoninë dhe bashkekzistencën fetare në Shqipëri, do të kryejmë një studim metodologjik, ku do të na vijnë në ndihmë intervistat dhe, për t'i pasqyruar ato, do të përdoret metoda cilësore. Intervistat që do të realizojmë, do të jenë me të rinjtë 18-35 vjeç nga qytete të ndryshme të Shqipërisë. Do të kryhet me të rinjtë e kësaj moshe për të kuptuar më tepër lidhjen që ka rinia e sotme me besimin dhe sa janë të informuar në këtë fushë, dhe sa informacion kanë në lidhje me tolerancën fetare që ekziston në këtë vend.

Kushtet për përzgjedhjen e personave në intervistë:

1. Intervistuesit do të mbeteshin anonimë⁸⁸.
2. Intervistat do të zhvillohen në baza vullnetare pa kompensim financiar apo diçka tjetër.
3. Të intervistuarit do t'i përkisnin besimeve të ndryshme fetare⁸⁹.
4. Të intervistuarit duhet të ishin persona që banojnë në Shqipëri.
5. Demografia e të intervistuarave do të ishte e gjerë në shtrirje, pra do të përfshinte disa qytete të këtij vendi.
6. Moshë e të intervistuarve do të jetë 18-35 vjeç.
7. Intervistat do të zhvilloheshin me audio⁹⁰.

Në realizimin e këtyre intervistave, secila intervistë zgjati disa minuta. Vendet e takimit ndryshonin në varësi të të intervistuarit si në lokale, rrugë, shkollë, telefon. Pyetjet kryesore që i parashtruam, ishin në lidhje me qytetin, moshën e tyre, përkatësinë fetare dhe nëse ishin praktikantë të fesë që i përkisnin dhe pyetja e fundit ishte mendimi personal në lidhje me tolerancën

⁸⁸ Interesant është fakti që shumë prej të intervistuarve u treguan të gatshëm të jepnin emrin e tyre, por, pavarësisht nga kjo, ne do ta ruajmë anonimitetin e tyre.

⁸⁹ Të intervistuarit do të pyeten nëse janë praktikantë apo jo të besimit që i përkasin, për të kuptuar më gjerë mendimin e tyre në lidhje me tolerancën.

⁹⁰ U vendos zhvillimi i intervistave në regjistrim me audio, për faktin se në këtë mënyrë mund të mos humbisnim asgjë rreth argumenteve të tyre.

fetare në vendin tonë. Le të njihemi me disa nga përgjigjet më interesante të njerëzve në lidhje me tolerancën fetare.

Subjekti 1: Femër, 28 vjeçe, Tiranë, e krishterë orthodhokse (praktikante)

“Mendoj që në Shqipëri ekziston një harmoni fetare, pasi Shqipëria është një vend laik, është gjithashtu edhe multifetar. Përveç besimeve fetare tradicionale, e ushtrojnë veprimtarinë e tyre edhe shumë besime të tjera, duke jetuar në paqe dhe harmoni të plotë. Kjo është trashëguar brez pas brezi edhe nga modeli që kanë gjetur në këtë vend. Pra, dëshmohet që harmonia që kanë gjetur shqiptarët është një tregues i kulturës së tyre të madhe dhe dëshmi e kulturës evropiane. Këtë harmoni e shohim edhe ndërmjet takimeve që bëhen midis komuniteteve fetare, në institucione, ndërmjet simpoziumeve të ndryshme. Pra, kemi një bashkëjetesë me dialogë dhe këto kanë ekzistuar dhe vazhdojnë të ekzistojnë dhe shihen si një thesar i çmuar për vendin tonë”.

Subjekti 2: Femër, 31 vjeçe, Elbasan, e krishterë orthodhokse (praktikante)

“Mendimi im është që në Shqipëri ekziston dhe është e pranishme toleranca fetare dhe kjo shihet nga disa faktorë. E para se ndërmjet komuniteteve të ndryshme fetare zyrtare, këtu në vendin tonë ka pasur komunikim të vazhdueshëm; e dyta ka pasur dialogë ndërmjet tyre, ka pasur bashkëpunime në fusha të ndryshme, gjithashtu takimet ndër-fetare. Këto janë një faktor që tregojnë që, në Shqipëri, është prezente toleranca fetare duke qenë se janë përpjekur që edhe çështjeve të ndryshme t’u japin zgjidhje të përbashkët, duke pasur komunikim mes tyre. Toleranca fetare në vendin tonë gjithashtu është një shembull mjaft i mirë edhe për shtetet e tjera që ta ndjekin”.

Subjekti 3: Femër, 21 vjeçe, Vlorë, myslimane (praktikante)

“Toleranca fetare është konsideruar gjithmonë si një vlerë e madhe e popullit shqiptar, por, nëse e shohim më thellë, ne vërejmë që, përtej fasadës që këta njerëz duhet të punojnë bashkë, të jetojnë bashkë për shkak të rutinës së tyre. Kjo tolerancë shihet më tepër si e detyruar dhe jo e dëshiruar. Respekti ndaj njëri-tjetrit është një veçori që e dallon këtë popull dhe toleranca më tepër ngelet mit sepse te të rinjtë e sotëm ka mungesë të njohurive ndaj besimeve fetare dhe mendojnë se toleranca

ekziston pa ditur kuptimin e vërtetë të tolerancës”. Mungesa e njohurive të të rinjve ndaj besimeve fetare për ta shihet si tolerancë.

Subjekti 4: Femër, 33 vjeçe, Tiranë, ateiste

“Shqiptarët nuk kanë tolerancë fetare, shqiptarët janë më tepër ateistë sesa tolerantë fetarë. Nga mënyra se si kanë jetuar në komunizëm, i ka humbur besimi dhe një pjesë e mirë e shqiptarëve nuk e ndiejnë nevojën për të besuar në Zot, edhe funksionojnë shumë mirë pa pasur nevojë të besojnë në Zot. Ajo që shihet si tolerancë fetare në vendin tonë, është thjesht një formë “e maskuar” e ateizmit. Tolerancë fetare ka kuptimin të jesh praktikant i një religjioni, të besosh te Zoti dhe religjioni të cilit ti i përket dhe njëkohësisht të respektosh edhe religjionet e tjera. Por, fatkeqësisht, në vendin tonë nuk ndodh kështu, sepse në Shqipëri, ajo që duket si tolerancë fetare, është në vetvete besimi i dobët dhe kështu njerëzit e kanë shumë më të lehtë ta tolerojnë edhe fenë e një tjetri sepse ata vetë nuk praktikojnë asnjë fe.

Subjekti 5: Femër, 19 vjeçe, Tiranë, agnostike

“Jam agnostike për faktin se nuk e mohoj prezencën e Zotit dhe unë si agnostike e kam të pamundur të di nëse ka diçka të mbinatyrshme apo jo. Në lidhje me tolerancën fetare në vendin tonë, mendoj që ajo nuk ekziston, është më tepër indiferentizëm sesa tolerancë. Shumica e popullit shqiptar nuk praktikon ritet fetare, pra fenë. Thjesht identifikohen me një fe të caktuar, por pa e praktikuar atë dhe në këtë mënyrë janë indiferentë ndaj fesë dhe jo tolerantë”.

Subjekti 6: mashkull, 27 vjeç, Berat, bektashi (praktikant)

“Lidhur me çështjen e tolerancës fetare, mendoj që në Shqipëri ekziston tolerancë fetare, është një nga vlerat që mbart në vetvete shoqëria shqiptare për shkak se njerëzit janë totalisht të lirë në besimet e tyre, totalisht në harmoni me besimet e tyre. Këtë gjë e vërtetojnë më së miri edhe fshatrat e Shqipërisë ku në to ndodhen edhe kisha, edhe xhami në të njëjtin pozicion. Njerëzit gjithmonë janë në harmoni të plotë me njëri-tjetrin. Një nga arsyet për të cilën Bashkimi Evropian duhet të

ndihet krenar është fakti që shqiptarët sot gëzojnë dhe kanë harmoni fetare si një shembull mjaft i mirë i bashkëjetesës ndërmjet komuniteteve që ndodhen në këtë vend”.

Subjekti 7: Mashkull, 27 vjeç, Fier, romano-katolik (praktikant)

“ Besoj se mund të thuhet me bindje që ekziston tolerancë e shëndetshme fetare në Shqipëri. Dhe në këtë vend toleranca fetare nuk ka të bëjë vetëm me pranimin e besimeve të tjera, por qëndron edhe në pranimin e atyre që nuk praktikojnë apo nuk besojnë, si edhe anasjelltas. Një nga veçoritë e shtetit shqiptar ka qenë se, përgjatë historisë, ka pasur ndikim edhe nga lindja, edhe nga kulturat perëndimore. Në të njëjtën kohë, kultura jonë, me të mirat e të këqijat, ka qenë diçka e brendshme dhe nuk kemi tentuar ta zgjerojmë e ta rrënjosim atë në vendet e tjera rreth nesh (gjë që nuk është e habitshme për një vend të vogël). Si pasojë, duke mos hedhur poshtë kontributin që mund të kemi pasur si kulturë në antikitet e, në disa raste të caktuara, përgjatë historisë, Shqipëria më shumë është ndikuar dhe është përshtatur me kulturat fetare të vendeve me influencë, duke përqaftuar pjesë prej tyre. Por, më interesante se aspektet gjeografike dhe historike, mendoj se është situata aktuale në shoqërinë shqiptare. Do të thosha se si pikënisje në këtë drejtim janë çështjet financiare dhe ekonomike, si edhe përqaftjet sesi individit e familjet përballojnë problemet e lidhura me to. Ndërkohë që ndikimi në kulturor është i izoluar dhe i paunifikuar. Jo vetëm kaq, por vihet re që toleranca fetare, në përgjithësi, nuk shoqërohet nga toleranca politike apo ajo për individualitetin. Vlerat universale që bashkojnë besimet e ndryshme në Shqipëri, shoqërohen edhe nga antivlerat që mund të quhen po "universale", dhe besimet fetare nuk kanë influencën e duhur për të ndikuar pozitivisht këtu. Dhe gjithë këta faktorë që përmenda ndërtojnë një shoqëri të caktuar që duket e ndihet kontroversale dhe e vështirë për t'u kuptuar në thelb. Por, për sa i përket tolerancës fetare, do të thosha se, ndonëse ajo që, padyshim, ekziston, mbetet diçka më pasive. Nuk mund të thuhet se feja është po aq e lidhur me kulturën sesa në vendet perëndimore apo në disa nga vendet e Lindjes, por, në të njëjtën kohë, nuk shkakton problematika që lidhen me politiken siç ndodh në disa vende të tjera. Gjithsesi, besoj se mbetet diçka pozitive në fund të fundit, sepse, pikësëpari, transmeton një frymë paqeje, sigurie dhe diversiteti në fusha, si turizmi, ku çështjet dhe problemet më të rrënjosura kanë ndikim më të limituar (edhe pse të ndjeshëm). Por, gjithashtu, është edhe një shembull që provon se balanca është e rëndësishme në shkallë shoqërore dhe se, nëse do të

ketë zhvillim të përgjithshëm në të ardhmen për shoqërinë shqiptare, bashkëjetesa e besimeve fetare ka potencial të marrë një formë më dinamike e kulturore, që transmeton vlera në mënyrë unike”.

Subjekti 8: Mashkull, 18 vjeç, Tiranë, mysliman (jopraktikant)

“Toleranca fetare është thelbësore për harmoninë sociale të njerëzve, duke lejuar bashkëjetesën paqësore dhe duke u ulur konfliktet midis shoqërive të ndryshme. Ajo mundëson shprehjen e lirë të besimit dhe pasuron shoqërinë duke promovuar diversitetin kulturor dhe duke respektuar të drejtat themelore të njeriut. Gjithashtu, toleranca fetare inkurajon dialogun, mirëkuptimin dhe lirshmërinë midis njerëzve të religjioneve të ndryshme, kapërcimin e ndarjeve dhe krijimin e komuniteteve më të forta. Gjithashtu mund të them se toleranca fetare shërben si një armë e fortë ndaj ekstremizmit dhe dhunës fetare, duke promovuar zgjidhje më paqësore. Vendi ynë, Shqipëria, njihet për tolerancën fetare dhe mendoj se çdo qytetar është krenar për këtë fakt. Kjo tolerancë e ka ndihmuar popullin shqiptar në mirëkuptimin e njëri-tjetrit dhe në uljen e konflikteve midis njerëzve të qyteteve të ndryshme”.

Subjekti 9: Femër, 18 vjeçe, Tiranë, e krishterë orthodhokse (jopraktikante)

“Vij nga një familje me përbërje të dy besimeve fetare, ai i krishterë orthodhok dhe mysliman. Dhe kemi gjetur një rrugë të ndërmjetme, për shembull: festojmë festat e të dyja besimeve ose frekuentojmë me raste si kishën edhe xhaminë. Raste të tilla në Shqipëri ka pa fund, sidomos prej faktit që pas vitit 1990, me rikthimin e lirisë së besimit, si pjesë e të drejtave të njeriut, shumë shqiptarë gjetën veten te një besim i caktuar dhe, me restaurimin e shumë objekteve fetare, patën mundësinë që edhe ta praktikojnë besimin e tyre. Si pjesë e një shteti shekullar, shqiptarët e kuptojnë se esenca e të besuarit qëndron në promovimin e tolerancës, empatisë dhe harmonisë sociale. Kuptojnë bukurinë e diversitetit dhe që uniteti nuk qëndron në konformitet, por në kultivimin e rrugëve të ndryshme drejtë spirtualizmit. Mendoj që një shembull i mirë është edhe qyteti i Shkodrës ku në të ndodhet një katedrale dhe një xhami vetëm pak metra larg njëra-tjetrës. Kjo tregon që uniteti i botës fetare nuk reflektohet vetëm te marrëdhëniet njerëzore, por edhe te vetë prania e institucioneve diverse të religjionit. Besimet fetare dhe përkatësia fetare mbeten

ngjyrat më të bukura që thurin identitetet e shqiptarëve, edhe mendoj që është një vlerë që do të ruhet edhe në vitet në vijim”.

Subjekti 10: Mashkull, 27 vjeç, Durrës, Mysliman (jopraktikant)

“Toleranca fetare përbën një nga vlerat më të mira themelore të shoqërisë. Për rrjedhojë, duhet të inkurajohet më tej, sepse kjo tolerancë përforcon më tej ekzistencën e kësaj bashkëjetese”.

Subjekti 11: Femër, 26 vjeçe, Elbasan, ateiste

“ Toleranca fetare në Shqipëri ekziston si koncept dhe si fenomen, por më tepër nga ana e jashtme, sepse shqiptarët nuk kanë krijuar ende një kulturë që ta pranojnë lirisht besimin e tjetrit. Kjo gjë duket edhe në marrëdhëniet se si njerëzit sillen me njëri-tjetrin, si për shembull në mjediset publike, urbane, në dyqane. Mendoj se duhet ende shumë punë për të arritur një koncept absolut në lidhje me tolerancën fetare në Shqipëri”.

Subjekti 12: Femër, 21 vjeçe, Burrel, Myslimane (jopraktikante)

“Në lidhje me tolerancën fetare mendoj se ajo ekziston në shoqëri, për faktin se çdo person është i lirë të zgjedhë çfarë beson mjafton që të mos cenohen të drejtat e gjithsecilit që mund të përfshihen në një rreth shoqëror. Ndërsa, në lidhje me martesën, nuk mendoj se ekziston sepse secili religjion ka stilin e vet të jetesës, përfshirë këtu festat, ritet fetare etj.

Subjekti 13: Femër, 35 vjeçe, Tiranë, myslimane (praktikante e mbuluar)

“Mendimi im në lidhje me tolerancën fetare, nëse do të më pyesje para se ta vija shaminë, do të ishte pozitiv, pra që Shqipëria ka tolerancë fetare. Ndërsa tani e shoh ndryshe, se ne, si popull, paragjykojmë shumë, por, pavarësisht nga kjo gjë, mendoj se ekziston tolerancë fetare. Ne si popull kemi harmoni me njëri-tjetrin, pavarësisht se në cilin besim bëjmë pjesë”.

Subjekti 14: Mashkull, Fier, i krishterë orthodhoks (praktikant)

“ Në lidhje me tolerancën fetare, mendoj që po, ekziston, sepse, nëse e krahasojmë me vendet e tjera ku ka ndërthurje fetare, nuk janë njësoj me Shqipërinë. Në Shqipëri, të gjithë praktikuesit e besimeve të ndryshme, unë mendoj se janë tolerantë, sidomos intelektualët që i përkasin besimeve të ndryshme, vetëm në raste të rralla disa radikalë, mund të thosha e nuk kanë një tolerancë të tillë”.

Subjekti 15: Mashkull, Berat, 27 vjeç, i krishterë orthodhoks (praktikant)

“Toleranca fetare ekziston në Shqipëri dhe është diçka që na bënë të krenohemi para kombeve të tjera. Sigurisht, kjo është e ndikuar edhe nga krerët tanë, pra prijësit tanë fetarë, por edhe ata shtetërorë, të cilët përpiqen që të mbajnë një harmoni dhe të kemi një respekt të veçantë për cilindo. Sepse, në fund të fundit, ne jemi të gjithë njerëz dhe secilin Perëndia e ka krijuar unik”.

Subjekti 16: Mashkull, Lushnjë, 24 vjeç, i krishterë orthodhoks (praktikant)

“Në lidhje me tolerancën fetare, mendoj se edhe ekziston, por edhe nuk ekziston. Në aspektin si praktikant që jam, mendoj që nuk ekziston për arsye se, në shumë biseda, ku i përkasin besimeve të ndryshme, gjithmonë ka kundërshtime dhe asnjëherë tolerancë. Ndërsa që ajo ekziston, e shoh që ka harmoni fetare, për shkak se krerët tanë fetarë janë munduar të krijojnë një union për ta mbajtur këtë harmoni”.

Subjekti 17: Mashkull, Fier, 26 vjeç, i krishterë orthodhoks (praktikant)

“Mendoj që Shqipëria është një oaz i tolerancës fetare, i gjendjes sociale që ka ardhur si rrjedhojë e faktorëve të ndryshëm, kryesisht historikë dhe politikë. Motivi kryesor është fakti se trojet shqiptare nuk kanë qenë pothuajse kurrë të bashkuara në një fe unike, monoteiste të paktën që prej skizmës së madhe të shekullit XI. Më tej, me vendosjen e islamit, përgjatë pesë shekujve të pushtimit osman që krijoi edhe një pol të tretë fetar. Pra, le të themi se populli ynë, në përgjithësi,

nuk ka qenë “partizan i flaktë” i qëndrimit besnik ndaj një besimi fetar, përgjatë gjithë ekzistencës së tij. Shembulli më i prekshëm i kësaj është Heroi ynë Kombëtar “Gjergj Kastriot Skënderbeu”, i cili, në periudha të ndryshme të jetës, ka qenë pjesë e të trejave. Megjithatë, edhe pse mund të duket paradoksale, mendoj që ky liberalizëm fetar që gëzon sot Shqipëria, një pjesë të rrënjëve e ka edhe te vendosja e ateizmit si politikë shtetërore gjatë diktaturës komuniste. Tashmë, përkatësia fetare kishte zero rëndësi. Të gjithë ishin njësoj komunistë dhe ateistë. Kjo politikë prodhoi indiferentizmin fetar, të cilin e hasim në të vërtetë ende të fortë në ditët tona. Fetë janë rikthyer pak nga pak po rifitojnë terren, por nuk kanë pjesëmarrjen si më parë. Në Shqipëri, shoqëritë krijohen pa përkatësi fetare, martesat lidhen pa përkatësi fetare, tregtia zhvillohet pa përkatësi fetare. Prej më se 100 vjetësh, shprehja që përmbledh ndoshta më mirë raportin e shqiptarëve me besimet, na thotë se: “Feja e shqiptarit është shqiptaria”.

Subjekti 18: Femër, 30 vjeçe, Tiranë, Bekashie, (jopraktikante)

“Në lidhje me tolerancën fetare, mendoj që një brez i ri është shumë tolerant dhe ka harmoni fetare me njerëzit që i përkasin besimeve të tjera. Kjo vjen edhe si pasojë nga mungesa e informacionit në lidhje me tolerancën dhe ngaqë nuk janë praktikantë të besimit që i përkasin”.

Subjekti 19: Femër, Durrës, 27 vjeçe, Myslimane (praktikante)

“Njerëzit që i përkasin besimit mysliman, pjesë e të cilit jam edhe unë, janë tolerantë fetarë, sepse, në besimin tonë, myslimani duhet t’i respektojë të gjithë besimtarët, edhe ata që i përkasin feve të tjera. Ndërsa të krishterët që janë praktikantë të besimit të tyre, janë intolerantë ndaj feve të tjera, ngaqë i paragjykojnë ato”.

Kapitulli i katërt


Diskutim mbi intervistat

Në këtë kapitull do të analizojmë më në thellësi intervistat e zhvilluara, duke përdorur metodën sasimore. Do të shohim përgjigjet e intervistuarve dhe do të japim një koment në lidhje me këtë. Më pas do të shohim nga ana sasimore dhe në fund do të kemi mundësi t'i përgjigjemi pyetjes së kapitullit të tretë nëse toleranca fetare ndihet dhe është e vërtetë apo përbën një mit për shoqërinë shqiptare.

Intervistat që u zhvilluan, në total ishin 25, por 6 prej tyre nuk patën dëshirë të përgjigjeshin, duke shprehur se nuk kishin informacion në lidhje me këtë fushë. Nga 19 të rinj që dhanë përgjigje, 11 ishin femra dhe 8 meshkuj.


Qyteteve që u përkisnin, ishin:

1. Tirana- U intervistuan 7 të rinj
2. Fieri- U intervistan 3 të rinj
3. Durrësi- U intervistuan 2 të rinj
4. Berati- U intervistuan 2 të rinj
5. Elbasani- U Intervistuan 2 të rinj
6. Burreli- U intervistua 1 i ri
7. Vlora- U intervistua 1 i ri
8. Lushnja- U intervistua 1 i ri



Nga 19 persona që u intervistuan:


1. Myslimanë- 6 të rinj
2. Të krishterë orthodhoksë- 6 të rinj
3. Romano-Katolikë- 2 të rinj
4. Bektashinj- 2 të rinj
5. Ateistë- 2 të rinj
6. Agnostikë- 1 e re



Në intervistat e zhvilluara, gjithashtu i pyetëm të rinjtë, përveç besimit që i përkisnin, por edhe nëse e praktikonin atë, pra ndiqnin shërbesat, ritet fetare të besimit që i përkisnin. Përgjigjet janë si më poshtë:


1. Myslimanë- 3 praktikantë dhe 3 jopraktikantë
2. Të krishterë orthodhoksë- 5 praktikantë dhe 1 jopraktikant
3. Romano-Katolikë- 2 praktikantë
4. Bektashinj- 1 praktikant dhe 1 jopraktikant

Përgjigjet do t'i paraqesim gjithashtu edhe në mënyrë grafike më poshtë.



Në intervistat e zhvilluara, për sa i përket gjinisë që i përkisnin, kemi:

1. Femra- 11
2. Meshkuj- 8




Intervistat që u zhvilluan me të rinjtë kishin si qëllim mendimin e tyre për tolerancën fetare nëse është ekzistuese apo jo në vendin tonë. Në 19 persona që u intervistuan:

1. 11 të rinj- Pro (toleranca fetare është e pranishme në Shqipëri)
2. 4 të rinj- Kundër (nuk është e pranishme në vendin tonë)
3. 4 të rinj- Skeptikë (edhe ekziston, edhe nuk ekziston)

Përgjigjet gjithashtu i shohim më poshtë të paraqitura në mënyrë grafike.


Përgjigjet në lidhje me Tolerancën Fetare



Nga intervistat e zhvilluara gjithashtu morëm përgjigje që:

1. Besimtarë praktikantë: 7- Pro tolerancës fetare dhe 2- Kundër
2. Besimtarë jopraktikantë: 4- Pro tolerancës fetare dhe 0- Kundër
3. Ateistë: 3- Kundër tolerancës fetare dhe 0- Pro
4. Skeptikë: Praktikantë- 2 të intervistuar dhe jopraktikantë- 1 i intervistuar.

Le ta shohim të paraqitur edhe në mënyrë grafike.



Shohim që personat që janë ateistë, pra që nuk kanë lidhje me asnjë prej religjioneve, shprehen kundër ekzistencës së tolerancës fetare në Shqipëri. Për ta, kjo tolerancë shihet vetëm në sipërfaqe. Gjithashtu, shohim se pjesa më e madhe e të intervistuarve që janë praktikantë të besimit që i përkasin, shprehen pro ekzistencës së tolerancës dhe një pjesë e vogël e tyre shprehet kundër. Ndërsa, personat që nuk e praktikojnë besimin që i përkasin, gjithë pjesa dërmuese e tyre shprehet pro ekzistencës së tolerancës.

Toleranca fetare në Shqipëri është trajtuar gjithmonë si një vlerë e jashtëzakonshme e këtij populli, një vlerë kombëtare, krenarie që i bënë ata të dallueshëm nga popujt e tjerë. Të gjendur pranë dilemës së madhe nëse në Shqipëri ka tolerancë, harmoni fetare, pjesëmarrësit në intervistat e zhvilluara na tregojnë se kjo tolerancë ekziston. Siç pritej, pjesa dërmuese u shpreh që kjo tolerancë ekziston ku shembulli i mirë është dialogu ndër fetar, i cili e ka forcuar edhe më tepër tolerancën e këtij populli. Faktorët që kanë ndikuar në zhvillimin e kësaj tolerance janë sipas disave: Indiferentizmi (shumë prej njerëzve janë parë si indiferentë fetarë dhe jo si tolerantë fetarë), ateizmi që është trashëguar nga periudha komuniste, respektimi për lirinë fetare të njëri-tjetrit. Intoleranca midis komuniteteve kryesore në Shqipëri gjen rrënjë në llojin fetar nga fundamentalizmi ekstrem dhe në atë jofetar, në faktorët politikë, psikologjikë, egoistë etj.

Bashkëjetesa që ekziston sot midis komuniteteve, mund të jetë e pranishme nga dy faktorë, si: indiferenca ndaj fesë dhe përvoja e ndërgjegjshme e thelbit më të thellë të fesë⁹¹. Disa prej shembujve që janë përmendur, janë: Martesat që kryhen pa përkatësi fetare, Kremtimet festive edhe të besimeve të tjera fetare, çështjet sociale, shoqërore etj.

Siç e pamë edhe më sipër, nga 19 të rinj të intervistuar, shumica prej tyre shprehen që kjo tolerancë ekziston. Në përgjigjet e tyre shohim që shprehen duke thënë se kjo tolerancë është trashëguar brez pas brezi përgjatë shekujve nga paraardhësit tanë dhe ka ardhur deri në ditët tona, shihet si diçka pozitive, tregues i kulturës së këtij populli ku kishat dhe xhamitë ndërtohen pranë njëra tjetrës. Toleranca fetare është parë edhe si ndikuese në uljet e konflikteve dhe krijimin e një komuniteti më të fortë. Prijësit e komuniteteve kryesore fetare kanë luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin dhe promovimin e kësaj tolerance në takimet e zhvilluara midis tyre.

Një pjesë e vogël e të rinjve u shprehën se kjo tolerancë që është përfolur kaq shumë, nuk ekziston dhe është një mit i ngelur i vendit tonë. Kjo vjen për faktin se shqiptarët janë më tepër ateistë sesa tolerantë, duke qenë se shumica e shqiptarëve nuk kanë njohuri për besimin dhe besimi i tyre është i dobët. Shprehja që i ka karakterizuar përgjatë kohës, që nga ardhja e komunizmit deri më sot, ka qenë “ Feja e shqiptarit është shqiptaria”, duke lënë pas fenë e tyre; mungesa e kulturës së tyre i bënte të mos e pranonin besimin e njëri-tjetrit.

Një pjesë tjetër e të rinjve, një pjesë e vogël, ishin skeptikë në lidhje me tolerancën fetare ku u shprehën që edhe ekziston, edhe nuk ekziston, duke e parë në dy këndvështrime të ndryshme. U shprehën që ekziston në lidhje me atë shoqërore, sociale, por nuk ekziston te besimtarët praktikantë.

⁹¹ Fjalim i titulluar “ Feja si instrument për paqen”, prezantuar në Ministrinë për Përparimin e Lirisë Fetare, Tiranë, 18 nëntor 2019.

Përfundimi

Ky punim diplome kishte si qëllim studimin e tolerancës fetare në vendin tonë, si edhe atë që ekziston midis komuniteteve fetare. Është e rëndësishme që, në çdo studim, të ndërtojmë fillimisht bazën historike, me qëllim që, më pas, të arrijmë te destinacioni i kërkimit që, në rastin tonë, është ekzistenca e tolerancës fetare. Kjo temë ka në qendër të saj komunitetet më të rëndësishme fetare në Shqipëri, si edhe harmoninë e bashkëjetesës që ekziston ndërmjet tyre. Dhe për t'u njohur më mirë me këto komunitete, bëmë fillimisht një prezantim të ardhjes së tyre që në fillimet e tyre, vështirësitë që u përballën dhe situatën në të cilën ndodhen dhe institucionet që gëzojnë ato sot.

Në mënyrë të përmbledhur, dhamë edhe pjesën e komunizmit ku Shqipëria u shpall vendi i parë ateist në botë dhe shumica e objekteve fetare u shkatërruan. Pas komunizmit, komunitetet fetare në Shqipëri duhet të ringriheshin dhe të fillonin nga e para. Në vitin 1990, filloi dhe puna në lidhje me ringritjen e këtyre komuniteteve; objektet fetare që gëzojmë sot, janë mjaftueshme për sa i përket numrit të tyre.

Meqë tema përkon me tolerancën fetare në Shqipëri, pamë sesi edhe komunitetet fetare i dhanë një përqendrim të veçantë krijimit të Këshillit Ndërfetar në Shqipëri, ku pjesë e tij janë pesë komunitetet kryesore të këtij vendi. U njohëm me konferencat kombëtare dhe ndërkombëtare ku kishte marrë pjesë Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë dhe vlen të përmendet se, gjithmonë, në çdo deklaratë të tyre, ato nënvizojnë dialogun që duhet të ekzistojë midis të gjitha komuniteteve. Gjithashtu, ky Këshill gjithmonë ka dalë në deklaratat të vazhdueshme në lidhje me situatën të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare, për të promovuar gjithmonë gjuhën e dashurisë, si një nga gjuhët më të rëndësishme, të cilën duhet ta zotërojë secili prej nesh.

Toleranca fetare e këtij populli është parë gjithmonë si një vlerë e jashtëzakonshme, e mrekullueshme, si një mbiemër që e zotërojnë dhe u përket shqiptarëve. E rëndësishmja e këtij studimi ishte të njiheshim edhe me mendimin që kishin të rinjtë shqiptarë për këtë fenomen dhe se sa të përfshirë ishin dhe sa njohuri kishin në lidhje me tolerancën. Për të pasur një imazh më të qartë të tolerancës, nëse ndihet kjo e vërtetë te të rinjtë apo është një mit i ngelur nga tradita e trashëguar brez pas brezi, u bënë 19 intervista me të rinjtë nga qytete të ndryshme të Shqipërisë, ku të rinjtë mbetën anonimë. Në këto intervista, ata shprehën besimin e tyre, nëse e praktikonin ose jo, si edhe mendimin që kishin në lidhje me tolerancën fetare në vendin tonë. Një pjesë e vogël

e të rinjve nuk binin dakord në lidhje me tolerancën, por pjesa dërrmuese u shprehën pozitivisht për ekzistencën e saj.

Bashkëjetesa dhe harmonia fetare mund të konsiderohen me bindje të plotë si një nga tri vlerat më të spikatura të popullsisë shqiptare, krahas besës dhe mikëpritjes. Modeli i bashkëjetesës paqësore dhe harmonisë ndërfitare në vendin tonë ka shërbyer si vlerë identifikuese e kësaj shoqërie dhe si pjesë e identitetit kulturor dhe social. Tradita e bashkëjetesës paqësore që ekziston sot midis shqiptarëve, është vlerë e trashëguar shumëshekullore, e ruajtur dhe e kultivuar si një e mirë kombëtare⁹².

Si përfundim, toleranca shqiptare mbetet një vlerë e qytetarëve shqiptarë. Edhe pse shumica e të rinjve që u pyetën, u shprehën si praktikantë të besimit që i përkisnin, shqiptarët janë një popull që nuk e praktikojnë rregullisht apo nuk i ndjekin ritet fetare në mënyrë të vazhdueshme. Ardhja e komunizmit solli humbjen e nuancës shpirtërore që ata kishin në lidhje me besimin. Pavarësisht nga kjo, toleranca që kanë shqiptarët me njëri-tjetrin duke e parë larminë fetare të kësaj shoqërie, duke u ruajtur edhe në kohë të vështira e të errëta, përbën një arritje të jashtëzakonshme. Rol kyç në këtë tolerancë përbëjnë padyshim krerët fetarë që janë munduar gjithmonë ta rrisin dhe ta përçojnë gjithmonë e më lart këtë tolerancë që mbajnë në kryet e tyre shqiptarët.

⁹² Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Rast Studimor, Promovimi i mirëkuptimit, tolerancës dhe lirisë fetare në Shqipëri, 2019, fq. 42.

Bibliografia

Në shqip:

Anastas, J. *Kisha Orthodhokse në hapësirën e Shqipërisë së Sotme, Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë*, Tiranë: 2009.

Anastas, J. *Ringritja e Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë*, Tiranë: 2015.

Bourcart, J. *Shqipëria dhe shqiptarët*, Dituria, Tiranë, 2004.

Gjergj, S. *Feja dhe edukimi*, Friedrich Ebert Stiftung, Tiranë 2017.

Hopko, Th. *Besimi Orthodhoks*, Tiranë: Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë, Vol. 3, 2000.

J, Topulli. *Rigjallërimi i besimeve fetare në Shqipëri pas rënies së komunizmit*, Punim Doktorature.

Roberto, M. *Kombi dhe feja në Shqipëri 1920-1944*, Shtëpia Botuese: Elena Lika, Tiranë.

Stephanos, R *The Transmission of the Gospel in the Multireligious Society of Albania and the Rediffusion to the Oikoumene*, (Doctoral Thesis).

Ukgjini, *Kisha Katolike: Ukgjini, Nikë. Kisha Katolike në Trevat Shqiptare (Nga Shek. XI-deri sot)*. Tiranë, Qendra Botuese Shoqata Jezuitëve, 2017.

Në anglisht:

Elbasani, A. *Religion and Democratization in Past-Communist Albania: Is it Possible to be Islamic, Democratic and European at the Same Time*, 2010.

Sir Charles Eliot, *Turkey in Europe*, Edward Arnold, London, 1908.

Swire, J. *Albania the Rise of a Kingdom*, Arno Press & the New York Time, New York 1971.

Artikuj:

Andrea, Ll. *Historia e Krishterimit në Shqipëri*, <http://allukani.narod.ru/indeks6.htm> (marrë më 20/05/2023).

E.Topulli, *Besimet fetare në Shqipëri*, (Punim diplome)
<http://flurudha.blogspot.com/2014/06/besimet-fetare-ne-shqiperi-punim-diplome.html?mçl>.
(marrë më 09/05/2023).

Fetë kundër Censurit, bektashinjtë: Nuk u pyetëm, “Panorama”, 15 dhjetor 2012 (marrë më 03/07/2023).

Fjalim i titulluar “Feja si instrument për paqen”, prezantuar në Ministrinë për Përparimin e Lirisw Fetare, Tiranë, 18 nëntor 2019.

Islamizmi te shqiptarët, Kultura popullore 1995, nr. 1-2.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Rast Studimor, *Promovimi i mirëkuptimit, tolerancës dhe lirisë fetare në Shqipëri*, 2019.

P. Thëngjilli, “Perla”, *Faktorët për përhapjen e fesë islame në Shqipëri shek. XIV-XVII*, Revistë Shkencore, 2005 Nr. 2 (37) Botuesi: Fondacioni Kulturor Saadi Shirazi, Tiranë.

P. Thëngjilli, *Shqiptarët midis Lindjes dhe Perëndimit, 1505-1839, fusha fetare*, 1, Tiranë, 2002.

“Reporter.AL”, *Si u bë Shqipëria vendi i parë ateist në botë*, 28/08/2019.

Shqipëria si hapësirë e krishterimit, “Arbëria” 14 shtator 2014.

Burime në internet:

Albanian Profile, *Besimet Fetare Në Shqipëri*. <https://thealbanianprofile.com/besimet-fetare-ne-shqiperi/> (marrë më 17/05/2023).

Deklaratë <https://knfsh.al/en/> (marrë më 12/05/2023).

Deklaratë për shtyp në lidhje me situatën në Ukrainë <https://knfsh.al/en/> (marrë më 12/05/2023).

Deklaratë për shtyp lidhurën me situatën politike <https://knfsh.al/en/> (marrë më 12/05/2023).

Deklaratë e përbashkët për veprime të koordinuara në luftën kundër dhunës ndaj gruas dhe dhunës në familje <https://knfsh.al/en/> (marrë më 12/05/2023).

Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë pjesëmarrës në Konferencën Ndërkombëtare në Gjermani <https://knfsh.al/en/> (marrë më 09/05/2023).

Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë Organizon Konferencën Ndërkombëtare dhe Ndërfetare “Vllazëria në Humanizëm” <https://knfsh.al/en/> (marrë më 09/05/2023).

Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë: Dënojmë ashpër çdo formë terrori që godet humanizmin <https://knfsh.al/en/> (marrë më 12/05/2023).

Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë: Dhimbje dhe lutje për Sri Lankën <https://knfsh.al/en/> (marrë më 12/05/2023).

Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë dënon me forcë krimet e ISIS <https://knfsh.al/en/> (marrë më 12/05/2023).

Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë dërgon propozime në Kuvend për ndryshimet në Kodin e Familjes <https://knfsh.al/en/> (marrë më 12/05/2023).

KNFSH-ja zhvillon Forumin Ndërfetar në Gjirokastër <https://knfsh.al/en/> (marrë më 09/05/2023).

KNFSH-ja pjesë aktive e panelit ndërkombëtar të “Religions For Peace” <https://knfsh.al/en/> (marrë më 09/05/2023).

KNFSH-ja zhvillon forumin ndërfetar mbi rolin e liderëve fetarë dhe rinisë në parandalimin e ekstremizmit dhe radikalizimit <https://knfsh.al/en/> (marrë më 09/05/2023).

KNFSH-ja pjesë në simpoziumin ndërkombëtar organizuar nga Ministria e Jashtme e Austrisë <https://knfsh.al/en/> (marrë më 09/05/2023).

KNFSH- jzhvillon forum ndërfetar në Elbasan <https://knfsh.al/en/> (marrë më 09/05/2023).

Komunitetet Fetare, Thirrje për Qetësi: Dialogoni, jo dhunë <https://knfsh.al/en/> (marrë më 12/05/2023).

Krerët e Bashkësive Fetare Apel Gjermanisë dhe Francës për Hapjen e Negociatave <https://knfsh.al/en/> (marrë më 12/05/2023).

Ngushëllim për humbjen e jetës së një prej anëtarëve të Departamentit të Rinisë në KNFSH <https://knfsh.al/en/> (marrë më 12/05/2023).

Ngjallja, “Vetëfljimi”, Kishat dhe Sektet <https://knfsh.al/en/> (marrë më 12/05/2023).

Objekte Religjose (Harmoni Religjose) <https://tirana.al/pika-interesi/kryegjyshata-boterore-bektashiane>. (marrë më 25/05/2023).

Pogradec, zhvillohet forumi ndërfetar me Departamentin e Gruas dhe Rinisë në KNFSH <https://knfsh.al/en/> (marrë më 09/05/2023).

Thirrje për pjesëmarrje në votime <https://knfsh.al/en/> (marrë më 12/05/2023).

Zhvillohet Konferenca Ndërkombëtare mbi Dialogun Ndërfetar ICID <https://knfsh.al/en/> (marrë më 09/05/2023).

Zhvillohet Konferenca Kombëtare: “Besimet Fetare Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore në Shqipëri” <https://knfsh.al/en/> (marrë më 09/05/2023).

Zhvillohet në Rimini të Italisë Konferenca “Rruga Adriatike e Dialogut Ndërfetar” <https://knfsh.al/en/> (marrë më 09/05/2023).

30 vjet nga Rithemelimi i KMSH-së https://dritaislame.al/30-vjet-nga-rithemelimi-i-kmshe/?amp#_ftn9. (marrë më 25/05/2023).